

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE

KORRIK 2022

<i>Nr</i>	<i>Përmbajta</i>	<i>Faqe</i>
-----------	------------------	-------------

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3-7
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7-10

II.HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

a) Objektivat dhe qëllimi.	11
b) Identifikimi i çështjes.....	12
c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
d) Përgjegjësitë e audituesve.....	12
e) Kriteret e vlerësimit.....	12
f) Standardet e auditimit.....	13
g) Metodat e auditimit.....	13
h) Dokumentimi i auditimit.....	14

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.....	14
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	14
2.1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.....	14-24
2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	24-29
2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	29-34
2.4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.....	34-39
2.5. Prokurimet e fondeve publike.....	39-75
2.6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të MFK.....	76-80
2.7. Vlerësimi i Auditit të Brendshëm.....	80-84

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....84-87

V. ANEKSE.....87

VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT.....87-94

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHó, në zbatim të Programit të Auditimit nr.380/1, datë 12.04.2022, në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, nga data 11.04.2022 deri më 10.06.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri më datë 31.03.2022, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie.

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi aktivitetin financiar dhe të përputhshmërisë së veprimtarisë së DSHQ, auditori drejtimet kryesore, në auditimin e pasqyrave financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore, të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në varësi të Kryeministrit, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin për ndërmarrjet shtetërore.

Sa më sipër, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare vepron mbi bazën ligjore të mëposhtme:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

-Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó;

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 óMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHó, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;

-Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó indryshuar;

- Ligji nr.114/2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publikó;

-Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, óPër Ndërmarrjet Shtetëroreó.

-Vendimi nr.34, datë 7.1.1999, óPër Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Lartaó.

- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 óPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyreó, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 óPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998ó;

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó;

- VKM nr.918 datë 29.12.2014 óPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronikeó;

- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 óPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikó, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 óMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronikeó i ndryshuar;

-VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 óPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publikeó.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

N R	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raporti n Përfund	Rëndësia	Rekomandimi

		imtar		
1	Nga auditimi i PBA-ve të përgatitura nga institucioni konstatohet se: - Për vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 12-mujore të buxhetit. DSHQ financohet nga buxheti i shtetit për llogarinë 603-Subvencione dhe llogarinë 231-Investime. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që DSHQ bën me Kryeministrinë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenonë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, <i>“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”</i>. - Grupi i auditimit konstatoi se institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar. Në programin ekonomik të secilit vit, institucioni ka bërë parashikimin dhe ka vendosur objektivat vetëm për vitin pasardhës, dhe jo për një periudhë afatmesme, duke mos përcaktuar objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave.	14-24	I MESËM	DSHQ të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore. - DSHQ të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe bazën e objektivave, të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit.
2	Dosjet personale të nëpunësve kanë mangësi dhe parregullsi në dokumentacion si: fleta e inventarit është e pafirmosur nga i punësuar dhe nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore; mungesa e raportit mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kontrollin mjekësor bazë, si dhe dëshmitë e panoterizuara, veprime në kundërshtim me VKM nr. 117 datë 5.03.2014 <i>“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”</i> dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 <i>“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”</i>, lidhja 1, ku evidentohen dokumentet që duhet të jenë pjesë e dosjes së personelit.	24-29	I MESËM	Spektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa nga për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas bazës ligjore në fuqi.
3	Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se sa i takon zyrave të DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit në raportin përfundimtar, janë evidentuar aktive të cilat konsiderohen si jashtë përdorimit për shkak të ndryshimit të teknologjisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”,</i> i ndryshuar, pika 96 <i>“Për procesin e vlerësimit të aktiveve është një proces që kryhet gjatë ose pas</i>	29-34	I MESËM	Titullari i institucionit të DSHQ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komisioni i Inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes

	<i>procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.”</i>			jashtë përdorimi.
4	Nga auditimi i dosjeve të prokurimit rezultoi sa më poshtë vijon: - Nga auditimi u konstatua se në DSHQ dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit. - Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, ÒPËR PROKURIMIN PUBLIKË pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.	39-75	I MESËM	-Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor. - Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të merren masa për të gjitha rastet e procedurave të prokurimit në vijim, hartimi i procesverbalit nr.2 të hapjes dhe vlerësimit të ofertave të kryhet në përputhje me bazën ligjore në mënyrë respektimin e transparencës në këto procedura.
5	- Nga auditimi u konstatua se, punonjësit janë trajnuar mbi menaxhimin e riskut vetëm në muajin Nëntor 2019 por nuk janë trajnuar në vitet pasardhëse në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÒPër menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. - Institucioni nuk ka krijuar faqen e tij zyrtare website.	76-80	I MESËM	Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në

				ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit si dhe referuar kapitullit III të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. -Titullari i Institucionit duhet të marrë masa për krijimin e faqes zyrtare WEBSITE të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare me qëllim rritje e transparencës së institucionit.
6	Nga auditimi u konstatua se struktura e auditit të brendshëm ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë) duke çuar në uljen e numrit të auditimeve gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë për raportet e auditimit.	76-80	I MESËM	Titullari i Institucionit të marrë masa, për plotësimin e vendit vakant pasi mungesa e përgjegjësit të sektorit të auditimit cenon procesin e auditimit dhe reflektohet në performancën e këtij sektori e cila ka çuar në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga strukturat përgjegjëse.
7	Nga auditimi në terren i kontratës <i>óHidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseve</i> me nr.1871/9 prot., datë 24.08.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik <i>óB.ô sh.p.k.</i> dhe <i>óE. K.ô sh.p.k.</i> me vlerë 24,653,040 lekë pa tvsh, u konstatua se gjatë zbatimit nuk justifikohet zëri: Transport dheu me auto deri 10.0 km, sasia 379.65 m3, me vlerë totale 170,846 lekë pa tvsh	39-75	I LARTË	Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE <i>óBë ô sh.p.k.</i> dhe <i>óE. Kô sh.p.k.</i> në vlerën 170,846 lekë pa tvsh.
8	Nga auditimi në terren i kontratës <i>óSuvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve</i> me nr.617/20 prot., datë 06.05.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik <i>óT.ô sh.p.k.</i> dhe <i>óShë ô sh.p.k.</i> me vlerë 9,264,800 lekë pa tvsh, u konstatua se gjatë	39-75	I LARTË	Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga

	zbatimit ka punime të situacionuara por të pajustificuar me vlerë totale 249,900 lekë pa tvsh.			operatori ekonomik BOE óT.ô sh.p.k. dhe óSh.ô sh.p.k. në vlerën 249,900 lekë pa tvsh.
--	--	--	--	---

III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare u konstatua se:

- Për vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 12-mujore të buxhetit. DSHQ financohet nga buxheti i shtetit për llogarinë 603-Subvencione dhe llogarinë 231-Investime. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që DSHQ bën me Kryeministrinë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, *óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore*.

- Grupi i auditimit konstatoi se institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar. Në programin ekonomik të secilit vit, institucioni ka bërë parashikimin dhe ka vendosur objektivat vetëm për vitin pasardhës, dhe jo për një periudhë afatmesme, duke mos përcaktuar objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave.

- Dosjet personale të nëpunësve kanë mangësi dhe parregullsi në dokumentacion si: fleta e inventarit është e pafirmosur nga i punësuar dhe nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore; mungesa e raportit mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kontrollin mjekësor bazë, si dhe dëshmitë e panoterizuara, veprime në kundërshtim me VKM nr. 117 datë 5.03.2014 *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”* dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, lidhja 1, ku evidentohen dokumentet që duhet të jenë pjesë e dosjes së personelit.

- Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se sa i takon zyrave të DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit në raportin përfundimtar, janë evidentuar aktive të cilat konsiderohen si jashtë përdorimit për shkak të ndryshimit të teknologjisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, i ndryshuar, pika 96 ë óProcesi i vlerësimit të aktiveve është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.”*

- Nga auditimi i dosjeve të prokurimit se në DSHQ dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit..

Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, *óPËR PROKURIMIN PUBLIK* pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

- Nga auditimi u konstatua se struktura e auditit të brendshëm ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë) duke çuar në uljen e numrit të auditimeve gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë për raportet e auditimit.

- Nga auditimi në terren i kontratës *óHydroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseve* me nr.1871/9 prot., datë 24.08.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve

Ekonomik óB.ô sh.p.k. dhe óE. K.ô sh.p.k, me vlerë 24,653,040 lekë pa tvsh, u konstatua se gjatë zbatimit nuk justifikohet zëri:Transport dheu me auto deri 10.0 km, sasia 379.65 m3, me vlerë totale 170,846 lekë pa tvsh.

- Nga auditimi në terren i kontratës óSuvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseveó me nr.617/20 prot., datë 06.05.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik óT.ô sh.p.k. dhe óSh.ô sh.p.k, me vlerë 9,264,800 lekë pa tvsh, u konstatua se gjatë zbatimit ka punime të situacionuara por të pajustificuar, për disa zëra me vlerë totale 249,900 lekë pa tvsh.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pamodifikuar me theksim të çështjes ¹.)

Objektivi i audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne mundëm të auditonim pasqyrat financiare vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve Qeveritare, ku përfshihen pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më datën 31 dhjetor 2021, si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit DSHQ paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit në datën 31.12.2021 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar".

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin óPërgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiareó, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. (ISSAI 1700. 9;10, Manuali auditimit financiar faqja 141, 142, 154). Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Theksimi i çështjes:

- Nga auditimi i zërave të pasqyrës së óPozicionit Financiaró dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve konstatohet se institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga viti 2005-2016, për të cilat nuk janë krijuar provizione.Në pasqyrën e pozicionit financiar të DSHQ trashëgohet në vite një provizion, i lidhur me kërkesat e arkëtueshme në vlerën 29,400,000 lekë, baza metodologjike për llogaritjen e te cilit nuk është e qartë. Kjo shumë mund të përdoret nga DSHQ për të mbuluar disa nga kërkesat e arkëtueshme afatgjata pa shpresë arkëtimi, pasi të jenë kryer më parë të gjitha procedurat e duhura ligjore.

Përgjegjësitë e drejtuesve të DSHQ.

Drejtimi i DSHQ është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të

¹ **OPINIONI I PAMODIFIKUAR me theksim të çështjes:** Një opinion i pamodifikuar me theksim çështje, jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5)

nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e grupit për të vazhduar aktivitetin e tij në vijimësi, duke dhënë informacion nëse është e zbatueshme për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë.

Raportimi mbi ecurinë e veprimtarisë dhe raportin e auditimit i jep mundësinë Drejtuesve të DSHQ që nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse, të informohen për zhvillimin dhe performancën e njësive ekonomike, shoqëruar me një përshkrim të risqeve dhe pasigurive kryesore, me të cilat njësia mund të përballë. Gjithashtu ky raport duhet të prezantojë në kohë ecurinë e veprimtarisë së DSHQ për: zhvillimet e mundshme, të ardhshme, të njësive ekonomike; aktivitetet në fushën e kërkimit dhe zhvillimit; informacionet që kanë të bëjnë me marrjen e aksioneve të veta; ekzistencën e degëve të njësive ekonomike; për përdorimin e instrumenteve financiare nga ana e njësive ekonomike dhe kur është materiale për vlerësimin e aktiveve, detyrimeve, pozicionit financiar, fitimit dhe humbjes; politikat dhe objektivat e menaxhimit të riskut financiar; ekspozimin e njësive ekonomike ndaj riskut të çmimit, riskut të kreditit, riskut të likuiditetit dhe riskut të flukseve monetare.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.

Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i Pamodifikuar/ Pakualifikuar)²

Në përputhje me programin e auditimit, grupi i auditimit ka audituar përputhshmërinë mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe respektimin e strukturave organike të miratuara, mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin, ekzekutimin dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, për të vlerësuar nëse çdo aspekt material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë DSHQ, të përshkruar në këtë Projektraport, ku është siguruar evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat nuk janë materiale.

Baza për kufizimin e sigurisë të opinionit të përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e projektraportit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018. Dokumentacioni administrativ, procedurat prokuruese, janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendimmarrjes nga DSHQ, me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi i përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i DSHQ, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe disa të meta e parregullsi, të konsideruara **jomateriale dhe jo të përhapura, për të cilën japim opinion të pakualifikuar.**

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

² Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, **Konkluzionet/ opinionet e pakualifikuara:** Kur audituesi nuk ka raste mospërputhshesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar: Në rastin e angazhimit me siguri të arsyeshme, që informacioni mbi çështjen dhe objektin e auditimit është përgatitur në çdo aspekt material në përputhje me kriteret e vlerësimit;

Drejtimi i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DSHQ, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetore të DSHQ për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues te personave me liri të kufizuar.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. Hyrja.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *óPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHó*, në zbatim të Programit të Auditimit nr.380/1, datë 12.04.2022, në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, nga data 11.04.2022 deri më 10.06.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri më datë 31.03.2022, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. M (*përgjegjës grupi*),
2. B. B, anëtar
3. A.Gj, anëtar
4. G.P, anëtar

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit janë dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.

Qëllimi i auditimit është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

4) Identifikimi i çështjes:

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në varësi të Kryeministrit, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin për ndërmarrjet shtetërore. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha:

- kryen shërbime qeveritare të pritjes së delegacioneve të huaja, të personaliteteve të larta etj., të cilët vijnë të ftuar nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave;
- trajton me kushte banimi e ushqimi delegacionet e rangjeve të larta, që vijnë në ministri e institucione qendrore;
- trajton e plotëson nevojat jetësore të personaliteteve të larta shtetërore;

- plotëson kushtet e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë shtetërore, si të mbledhjeve, konferencave, seminareve, veprimtarive ndërkombëtare etj., që kryhen në mjediset e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
 - në përputhje me aktet ligjore në fuqi ajo kryen aktivitetet tregtar siç është: dhënia me qira e vilave, objekteve që ka në administrim, si dhe kryen veprimtari ekonomike të turizmit e të shërbimeve hotelieri për persona fizike e juridike vendas e të huaj. Për nevojat e veçanta në rrethet ku nuk disponon rezidenca apo vila, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund të marrë objekte me qira nga subjekte shtetërore apo private, vendas apo të huaj;
 - në objektet e saj, ku ka organizuar restorante, trajton kundrejt pagesës edhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët e Kuvendit dhe titullarët e institucioneve të tjera qendrore. Rregullat e caktimit të çmimeve miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare;
 - kryen veprimtari shitblerjeje, veprimtari prodhimi me porosi, riparim shërbime, shërbime me taksë dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në zbatim të Programit të Auditimit nr.380/1, datë 15.04.2022.

5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare është përgjegjëse për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, rritjen profesionale të stafit, zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetjen në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm.

6) Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DSHQ-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Në komunikojmë me drejtuesit, ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

7) Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 *“Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;*
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;*
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar;
- Ligji nr.114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*;
- Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, *“Për Ndërmarrjet Shtetërore”*.
- Vendimi nr.34, datë 7.1.1999, *“Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e*

Personaliteteve të Larta.

- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 *óPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre*, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 *óPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998*;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*;
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 *óPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike*;
- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 *óPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik*, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 *óMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike* i ndryshuar;
- VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 *óPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike*.

8)Standardet e Auditimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
- Libri Jeshil i GAO-s;
- ISSAI 1000-2999 *óUdhëzues të Auditimit Financiar*;
- ISSAI 1300 *óPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*.

9)Medodat e auditimit

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të DSHQ, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, procedurat e prokurimeve dhe konkurrimeve duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet evlerësimi, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm.

10)Dokumentimi i auditimit

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë është realizuar, në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), mbështetur në ISSAI-n 10 *óDeklarata e Meksikës*, mbi Pavarësinë e (SAI), si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 *óStandardi i Auditimit të Përputhshmërisë*, ISSAI 1000-2999 *óUdhëzues të Auditimit Financiar*; ISSAI 1300 *óPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore *óMbi Procedurat e auditimit në KLSH*, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 , e ndryshuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, *për të realizuar objektin e auditimit*, për dhënien e opinionit financiar dhe të përputhshmërisë e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat mbi zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore

gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet evlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, Ligji 10296, datë 08.07.2010 *óMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”*, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 *óPër prokurimin publik*, i ndryshuar, -Ligji nr. 7582, datë 13.7.1992, *óPër Ndërmarrjet Shtetërore*, Vendimi nr.34, datë 7.1.1999, *óPër Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*, VKM nr. 918, datë 29.12.2014 *óPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike*, Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 *óPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik*, udhëzimin e APP-së nr. 2 datë 08.01.2018 *óMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike* i ndryshuar, VKM nr.160, datë 02.03.2016 *óPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”*.

II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në varësi të Kryeministrit, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin për ndërmarrjet shtetërore. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha:

- kryen shërbime qeveritare të pritjes së delegacioneve të huaja, të personaliteteve të larta etj., të cilët vijnë të ftuar nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave;
- trajton me kushte banimi e ushqimi delegacionet e rangjeve të larta, që vijnë në ministri e institucione qendrore;
- trajton e plotëson nevojat jetësore të personaliteteve të larta shtetërore;
- plotëson kushtet e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë shtetërore, si të mbledhjeve, konferencave, seminareve, veprimtarive ndërkombëtare etj., që kryhen në mjediset e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
- në përputhje me aktet ligjore në fuqi ajo kryen aktivitet tregtar siç është: dhënia me qira e vilave, objekteve që ka në administrim, si dhe kryen veprimtari ekonomike të turizmit e të shërbimeve hotelieri për persona fizike e juridike vendas e të huaj. Për nevojat të veçanta në rrethet ku nuk disponon rezidenca apo vila, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund të marrë objekte me qira nga subjekte shtetërore apo private, vendas apo të huaj;
- në objektet e saj, ku ka organizuar restorante, trajton kundrejt pagesës edhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët e Kuvendit dhe titullarët e institucioneve të tjera qendrore. Rregullat e caktimit të çmimeve miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare;
- kryen veprimtari shitblerjeje, veprimtari prodhimi me porosi, riparim shërbime, shërbime me taksë dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHETIT

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2020-2022, PBA-në 2021-2023 dhe PBA-në 2022-2024;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2020, 2021 dhe 2022 si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;

- 3) Raportet e monitorimit të realizimit të buxhetit;
- 4) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare financohet si më poshtë:

Ç Të ardhura që krijohen nga qiratë, nga hoteleria, nga shërbimet pritje-përcjellje, nga eventet etj.(vetëfinancim);

Ç Për shpenzimet korrente të pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shpenzimet kapitale për investime, subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Për shërbimet që ofron, DSHQ siguron të ardhura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj. Buxheti i DSHQ-së miratohet nga Këshilli Drejtues.

Për të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike-financiare, DSHQ përgatit programin ekonomik (buxhetin) dhe programin e zhvillimit për çdo vit kalendarik. Për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, DSHQ operon në përputhje me udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Viti 2019

Për vitin 2019, DSHQ ka përgatitur Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Me shkresën nr. 2907 datë 01.09.2020, DSHQ ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë PBA 2022-2024.

Parashikimi i shpenzimeve në PBA- në 2020-2022

N r	Artikujt	Tavanet 2020	Kërkesa 2020	Tavanet 2021	Kërkesa 2021	Tavanet 2022	Kërkesa 2022
1	603. Subvencione	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000
2	231.Investime	344,506	344,506	263,000	263,000	263,000	263,000
Totali		544,506	544,506	463,000	463,000	463,000	463,000

Viti 2020

Për vitin 2020, DSHQ ka përgatitur Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023. Me shkresën nr. 2907 datë 01.09.2020 DSHQ ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë PBA2021-2023.

Parashikimi i shpenzimeve në PBA- në 2021-2023

N r	Artikujt	Tavanet 2021	Kërkesa 2021	Tavanet 2022	Kërkesa 2022	Tavanet 2023	Kërkesa 2023
1	603. Subvencione	220,000	220,000	220,000	220,000	220,000	220,000
2	231.Investime	327,226	327,226				
Totali				220,000	220,000	220,000	220,000

Viti 2021

Për vitin 2021, DSHQ ka përgatitur Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Me shkresën nr. 3376 datë 30.08.2021, DSHQ ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë PBA 2022-2024.

Parashikimi i shpenzimeve në PBA- në 2022-2024

Nr	Artikujt	Tavanet 2022	Kërkesa 2022	Tavanet 2023	Kërkesa 2023	Tavanet 2024	Kërkesa 2024
1	603.Subvencione	250,000	250,000	250,000	250,000	250,000	250,000

2	231.Investime	346,726	346,726	1,668	1,668		
Totali				251,668	251,668	250,000	250,000

Me Vendimin e KD nr. 29 datë 27.08.2021 u miratua Projekt-Buxheti i vitit 2022 i DSHQ, ku u parashikuan Të ardhura dhe Shpenzime në shumën 434,381 mijë lekë.

Me Vendimin e KD nr. 50 datë 24.12.2021, KD shqyrtoi kërkesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, për Rishikimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe miratoi ndryshimin në Të ardhura dhe Shpenzime në shumën prej 475,334 mijë lekë.

b) Zbatimi i kriterëve në realizimin e planit të buxhetit.

Viti 2019

Në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 óPër buxhetin e vitit 2019ó, dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 óPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ó, DSHQ-sëi janë planifikuar fonde buxhetore për subvencione për shpenzimet korrente për vitin 2019 në shumën 220,000 mijë lekë dhe për shpenzimet kapitale investime është planifikuar një fond prej 327,226 mijë lekë.

Në mijë/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Parashikimi 2019	Realizimi 2019	% realizimit
1	Pagat	172,935	165,969	96%
2	Sig shoqërore&shëndetsore	28,760	27,247	95%
3	Udhëtime dhe dieta	7,700	3,773	49%
4	Shpenzime materiale	76,030	48,739	64%
5	Shpenz. Ushqimore	20,000	20,259	101%
6	Energji Elektrike	13,500	12,544	93%
7	Ujë	6,500	4,756	73%
8	Telefon	1,200	319	27%
9	Amortizim i AQT-ve	69,500	80,809	116%
10	Shpenzime te tjera	15,408	24,527	159%
11	Shpenzime pritje dhe përfaqësime	35,017	72,569	207%
	TOTALI	446,550	461,511	103%

Burimi: DSHQ

Nga analiza e zërave të të tabelës së shpenzimeve rezultojn se:

Për vitin 2019, shpenzimet në DSHQ ishin planifikuar në shumën 446,550 mijë lekë. Ato janë realizuar në vlerën 461,511 mijë lekë, ose 14,961 mijë lekë më shumë se parashikimi.

Në zërin *Shpenzimet për materiale* paraqiten në vlerën 48,739 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 96%.

Në zërin *Shpenzimet për energji elektrike, ujë dhe telefon* paraqiten në shumën 17,619 mijë lekë dhe përfshijnë shpenzimeve për energjinë, ujin dhe telefonin.

Në zërin *Shpenzimet Amortizimi i AQT*, janë realizuar në shumën prej 80,809 lekë, ku kemi një shtesë në raport me planifikimin në vlerën 11,309 mijë lekësh.

Zëri *Shpenzime ushqimore* paraqitet në shumën 20,259 lekë, ku kemi rritje në vlerën 259 mijë lekë, shpenzim i cili ndikim të drejtpërdrejt në gjenerimin e të ardhurave në zërin shërbimet e pritje në përcjellje.

Në zërin *Shpenzimet e tjera* kemi një rritje në vlerën 9,119 mijë lekë, kjo rritje vjen si rezultat i kërkesave të shtuara nga institucionet e larta shtetërore e private për zhvillimin e aktiviteteve të veçanta në ambientet që administrohen nga ana jonë. Ky fakt ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe gatishmëri të ambienteve.

Viti 2020

Në zbatim të Ligjit nr. 88/2019 óPër buxhetin e vitit 2020ó, si dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 20.01.2019 óPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ó dhe

Udhëzimit Plotësues Shtesë të Ministrit të Financave nr. 2/1 datë 21.09.2020, DSHQ-sëi janë planifikuar fonde buxhetore për subvencione për shpenzimet korrente për vitin 2020 në shumën 250,000 mijë lekë dhe për shpenzimet kapitale investime është planifikuar një fond prej 346,726 mijë lekë.

Në mijë/ lekë

Nr	Përshkrimi	Parashikimi 2020	Realizimi 2020	% realizimit
1	Pagat	185,438	161,017	87%
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	30,968	26,734	86%
3	Udhëtime dhe dieta	3,000	4,359	145%
4	Shpenzime materiale	57,839	48,016	83%
5	Shpenzime ushqimore	18,790	20,316	108%
6	Energji elektrike	13,000	11,688	90%
7	Ujë	3,000	4,506	150%
8	Telefon	600	413	69%
9	Amortizim i AQT-ve	69,500	76,451	110%
10	Shpenzime të tjera	22,316	14,401	65%
11	Shpenzime pritje dhe përfaqësime	26,962	38,315	142%
	TOTALI	431,413	406,216	94%

Burimi: DSHQ

Shpenzimet në total për vitin 2020, ishin planifikuar në shumën 431,413 mijë lekë. Ato janë realizuar në vlerën 406,216 mijë lekë, ose 25,197 mijë lekë më pak se parashikimi.

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore, për vitin 2020 janë në vlerën 161,017 mijë lekë dhe në krahasim me vitin e kaluar janë ulur në shumën 4,952 mijë lekë.

Në zërin *shpenzimet për materiale* janë realizuar në vlerën 48,016 mijë lekë dhe ka një rënie në krahasim me parashikimin e vitit 2020, në vlerën 723 mijë lekë.

Në zërin *shpenzime ushqimore* janë në vlerën 20,316 mijë lekë. Ky shpenzim ka ndikim të drejtpërdrejt në gjenerimin e të ardhurave në zërin shërbimet e pritje në përcjellje.

Shpenzimet për energji elektrike dhe ujë për vitin 2020 janë në vlerën 16,194 mijë lekë.

Shpenzimet për telefon për vitin 2020 janë në vlerën 413 mijë lekë krahasuar me parashikimin për vitin 2020 kemi një ulje prej 94 mijë lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i ndryshimit të paketave nga ana e punonjësve duke përfutur paketa më të lira për komunikim.

Në zërin *shpenzime amortizimi i AQT*, janë në masën 76,451 mijë lekë, konkretisht 6,951 mijë lekë më shumë se parashikimi i vitit 2020. Kjo rritje nga parashikimi vjen si pasojë e marrjes së disa kalime kapitalesh gjatë vitit 2020 të cilat rëndojnë në zërin e amortizimit të akumuluar.

Një ulje ka zëri *shpenzime të tjera*, ku përfshihen përveç të tjerave dhe shpenzimet për penalitete dhe gjoba, humbje të çështjeve gjyqësore etj. Në krahasim me parashikimin e këto shpenzime janë ulur në masën 7,915 mijë lekë.

Shpenzime pritje dhe përfaqësime për vitin 2020 është në vlerën 38,315 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2019 kemi një ulje prej 34,254 mijë lekë.

Viti 2021

Shpenzimet e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare në total për vitin 2021, ishin planifikuar në shumën 431,413 mijë lekë. Ato janë realizuar në vlerën 406,480 mijë lekë, ose 24,933 mijë lekë më pak se parashikimi.

Më poshtë paraqitet tabela e shpenzimeve për vitin 2021:

Në mijë/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani 2021	Realizimi 2021	% realizimit
1	Pagat	185,765	161,332	87%
2	Sig shoqërore & shëndetësore	29,431	26,800	91%
3	Udhëtime dhe dieta	3,000	6,633	221%
4	Shpenzime materiale	61,731	63,020	102%
5	Shpenzime ushqimore	18,290	19,093	104%
6	Shpenzime për pritje në përcjellje	26,962	26,597	99%
7	Energji Elektrike	13,000	12,441	96%
8	Ujë	3,000	5,415	181%
9	Telefon	600	196	33%
10	Amortizim i AQT-ve	75,316	69,813	93%
11	Shpenzime të tjera	14,318	15,140	106%
	TOTALI	431,413	406,480	94%

Burimi: DSHQ

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore, për vitin 2021 janë në vlerën 188,132 mijë lekë përkatësisht 161,332 mijë lekë për pagat e personelit dhe 26,800 mijë lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Ky shpenzim zë peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve në masën 39.84 %.

Në zërin *shpenzimet për materiale* janë realizuar në vlerën 63,020 mijë lekë dhe si rezultat i kthimit në normalitet të punës në DSHQ, ka një rritje në krahasim me parashikimin, në vlerën 1,289 mijë lekë.

Zëri *shpenzime ushqimore* është në vlerën 19,093 mijë lekë ose 803 mijë lekë më shumë se parashikimi. Rritja e këtij shpenzimi lidhet drejtpërdrejt me rritjen e të ardhurave në zërin shërbimet e pritje në përcjellje.


Shpenzimet për energji elektrike dhe ujë për vitin 2021 janë në vlerën 17,826 mijë lekë, përkatësisht 12,441 mijë lekë shpenzime energji elektrike dhe 5,415 mijë lekë ujë.

Shpenzimet për telefon për vitin 2021 janë në vlerën 196 mijë lekë dhe krahasuar me planin e vitit 2021 kemi më shumë se përgjysmim të shpenzimit. Kjo ulje drastike ka ardhur si rezultat i ndryshimit të politikës së likuidimit të faturave individuale të punonjësve që kanë shërbim mobile të kontraktuar në emër të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

Në zërin *shpenzime amortizimi i AQT*, janë në masën 69,813 mijë lekë, konkretisht 5,503 mijë lekë më pak se parashikimi. Ky shpenzim gjithashtu lidhet me kalimet e ndryshme të kapitaleve gjatë vitit të cilat kanë ndikim në zërin e amortizimit të akumuluar.

Një ulje ka zëri *shpenzime të tjera*, ku përfshihen përveç të tjerave dhe shpenzimet për penalitete dhe gjoba, humbje të çështjeve gjyqësore etj., është realizuar në masën 15,140 mijë lekë. Në këtë zë përfshihet gjithashtu dhe shpenzimi i tatim fitimit për vitin ushtrimor.


Shpenzime pritje dhe përfaqësime për vitin 2021 është në vlerën 26,597 mijë lekë ose 98.6% e planit. Krahasuar me parashikimin kemi një ulje prej 365 mijë lekë.



c) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave

Grupi i Menaxhimit Strategjik mbledh kërkesat nga secila drejtori, dhe me pas miratohet nga Këshilli Drejtues.

Më poshtë grafiku i parashikimit dhe realizimit të të ardhurave për periudhën 2019-2021:



Viti 2019

Plani i të ardhurave për vitin 2019 paraqitet si më poshtë:

Në mijë/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan 2019	Fakt 2019
1	Nga qiratë	73,000	72,940
2	Nga hoteleria	350	348
3	Nga shërbimet (pritje përcjellje)	40,000	49,091
4	Subvencioni i shtetit	210,000	200,000
5	Nga punime dhe shërbime të tjera	7,800	12,284
6	Kuota pjesëmarrje Sub nga investime	63,000	74,810
7	Të ardhura nga burime të tjera	7,400	14,750

8	Nga shërbimet, Eventet (pritje - përcjellje)	45,000	32,887
9	Nga subvencionit i shtetit (shpz me destinacion)	0	61350
	TOTALI	446,550	518,460

Burimi: DSHQ

Nga analiza e zërave të treguesve në tabelën e të ardhurave rezulton:

Të ardhurat gjatë vitit 2019, ishin planifikuar në vlerën 446,550 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 518,460 mijë lekë ose *71,910 mijë lekë* më shumë se planifikimi.

Të ardhurat nga qiratë u planifikuan për vitin 2019 në masën 73,000 mijë lekë dhe u realizuan në vlerën 72,940 mijë lekë ose 60 mijë lekë më pak se parashikimi.

Të ardhurat nga hoteleria, janë planifikuar në vlerën 350 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 348 mijë lekë ose 99% realizim të plani. Ndikim pozitiv në realizimin e kësaj të ardhure ka pasur shtimi i investimeve për sjelljen e këtyre ambienteve në kushtet e kërkuara bashkëkohore.

Të ardhurat nga zëri *Shërbime (pritje-përcjellje)*. Në këtë zë të ardhurash grupohen të ardhurat nga pritjet e përcjelljet e personaliteteve të larta vendas dhe të huaj. Për vitin 2019 janë realizuar në vlerën 49,091 mijë lekë ose *8,588 mijë lekë* më shumë se realizimi i vitit 2018, dhe në raport me planifikimin kemi tejkalim të planit me 22.7 % më shumë.

Të ardhurat nga subvencionit i shtetit për shpenzime korrente. Në këtë zë përfshihen të ardhurat që shteti i jep në formën e subvencionit për përballimin e shpenzimeve kryesisht të pagave dhe sigurimeve shoqërore për ato njësi ose sektorë që nuk gjenerojnë të ardhura. Për vitin 2019, është dhënë në formën e subvencionit për shpenzimet korrente vlera prej 200,000 mijë lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë akorduar Fonde Shtesë sipas: VKM Nr. datë 09.01.2019 për organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës, në vlerën 22,494 mijë lekë dhe VKM Nr.558 datë 31.07.20219 në kuadër të organizimit të edicionit të 41-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, në vlerën 66,973 mijë lekë.

Të ardhura nga Kuota pjesë e Subvencionit për investime. Për vitin 2019 të ardhurat nga ky zë janë planifikuar në vlerën prej 63,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 74,810 mijë lekë, ose *16,715 mijë lekë* më shumë se planifikimi. Këto të ardhura nuk pasqyrojnë direkt aktivitetin e DSHQ, por ndikojnë në rezultatin e institucionit.

Të ardhurat nga punime dhe shërbimet të tjera (parkimet & delegacionet). Të ardhurat nga ky zë për vitin 2019 janë realizuar 12,284 mijë lekë. Krahësuar me parashikimin kemi një tejkalim për *5,441 mijë lekë*.

Të ardhurat nga zëri *Të ardhura nga Burime të tjera* janë planifikuar në vlerën prej 7,400 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 14,750 mijë lekë, ose *3,350 mijë lekë* më shumë se planifikimi. Kjo për arsye të rritjes së numrit të aktiviteteve të organizuara në ambientet në përdorim nga DSHQ-së, rritje të Akt-Marrëveshjeve me subjekte shtetërore dhe private për dhënien me qira të ambienteve të jashtme të Pallatit të Brigadave. Këto janë të ardhura sekondare që nuk rrjedhin nga aktiviteti kryesor i DSHQ-së.

Të ardhura nga Eventet (pritje- përcjellje), janë të gjitha të ardhurat e krijuara nga aktivitetet dhe eventet e organizuara nga Drejtoria e Eventeve Qeveritare Publike dhe Jopublike për vitin 2019 është në vlerën *32,887 mijë lekë*. Krahësuar me parashikimin e këtij zëri kemi një ulje prej 12,113 mijë lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i anulimit të disa kontratave dhe aktiviteteve në 4 mujin e dytë të vitit 2019, pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme si pasojë e aktivitetit sizmik të ndodhur në territorin e Shqipërisë.

Viti 2020

Plani i të ardhurave për vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Në mijë/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Parashikimi 2020	Realizimi 2020
1	Nga qiratë	73,500	25,196
2	Nga hoteleria	400	338
3	Nga shërbimet (pritje përcjellje)	40,000	28,139
4	Subvencioni i shtetit	220,000	241,801
5	Nga punime dhe shërbime të tjera	7,113	6,452
6	Kuota pjese nga subvencioni për investimet	48,000	32,055
7	Të ardhura nga burime të tjera	7,400	2,524
8	Nga shërbimet, eventet (pritje - përcjellje)	35,000	30,063
9	Nga subvencioni i shtetit (shpz me destinacion)	0	50,970
	TOTALI	431,413	417,538

Burimi: DSHQ

Nga analiza e zërave të treguesve në tabelën e të ardhurave rezulton se:

Të ardhurat totale gjatë vitit 2020, ishin planifikuar në vlerën 431,413 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 417,538 mijë lekë ose në masën 97% të planifikimit. Në mungesë të realizimit të eventeve, peshën më të madhe të të ardhurave e zë subvencioni i rakorduar nga buxheti i shtetit në vlerën 241,801 mijë lekë.

Të ardhurat nga zëri qira për vitin 2020 janë realizuar në vlerën 25,196 mijë lekë, ose 47,744 mijë lekë më pak se realizimi i vitit 2019. Në këtë zë ndikim të drejtpërdrejtë ka situata e pandemisë botërore të virusit Covid-19. Ndalimi i zhvillimeve të aktiviteteve të ndryshme, ka ndikuar në dhënien me qera të Pallatit të Kongreseve apo organizimi i eventeve të ndryshme në Pallatin e Brigadave. Sot këto dy ambiente, të cilat gjeneronin të ardhurat kryesore për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, nuk janë të shfrytëzueshme.

Të ardhurat nga hoteleria janë parashikuar në 400 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 338 mijë lekë ose 84 % e planit.

Të ardhurat nga zëri *Shërbime (pritje-përcjellje)* për vitin 2020 janë realizuar në vlerën 28,139 mijë lekë ose 20,952 mijë lekë më pak se realizimi i vitit 2019. Gjithashtu dhe ky zë preket nga situata e pandemisë Covid-19.

Të ardhurat nga subvencioni i shtetit për shpenzime korrente. Në këtë zë përfshihen të ardhurat që shteti i jep në formën e subvencionit për përballimin e shpenzimeve kryesisht të pagave dhe sigurimeve shoqërore për ato njësi ose sektorë që nuk gjenerojnë të ardhura. Për vitin 2020, është dhënë në formën e subvencionit për shpenzimet korrente vlera prej 200,000 mijë lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2020 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë akorduar fonde shtesë sipas: me VKM.839, datë 28.10.2020 2,199 mijë lekë për organizimin e Samitit Dixhital të Ballkanit Perëndimor dhe 41,801 mijë lekë fonde shtesë për shpenzime operative të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

Të ardhurat nga punime dhe shërbimet të tjera (parkimet & delegacionet). Të ardhurat nga ky zë për vitin 2020 janë realizuar 6,452 mijë lekë. Krahësuar me parashikimin, i cili ishte në vlerën 7,113 mijë lekë, kemi një ulje prej 661 mijë lekë.

Të ardhura nga kuota pjesë e subvencionit për investime. Për vitin 2020 të ardhurat nga ky zë janë realizuar në vlerën prej 32,055 mijë lekë, ose 15,945 mijë lekë më pak se planifikimi. Këto të ardhura nuk pasqyrojnë direkt aktivitetin e DSHQ-së, por ndikojnë në rezultatin e institucionit.

Të ardhurat nga zëri *Të ardhura nga burime të tjera* janë planifikuar në vlerën prej 7,400 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 2,524 mijë lekë, ose 4,876 mijë lekë më pak se planifikimi. Kjo për arsye të uljes nga pandemia të numrit të aktiviteteve të organizuara në ambientet në përdorim nga DSHQ-së, uljes së Akt-Marrëveshjeve me subjekte shtetërore dhe private për dhënien me qira të ambienteve të jashtme të Pallatit të Brigadave.

Të ardhurat nga zëri *Të ardhura nga shërbimet, eventet (pritje – përcjellje),* janë të gjitha të ardhurat e krijuara nga aktivitetet dhe eventet e organizuara nga Drejtoria e Eventeve Qeveritare Publike dhe Jopublike për vitin 2020 është në vlerën 30,063 mijë lekë. Krahësuar me parashikimin e këtij zëri kemi një ulje prej 4,937 mijë lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i mos zhvillimit të aktiviteteve gjatë vitit 2020 si pasojë e pandemisë Covid-19.

Viti 2021

Plani i të ardhurave për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Në mijë/ lekë

Nr	Përshkrimi	Plani 2021	Realizimi 2021
1	Të ardhura nga qiratë	73,500	31,778
2	Të ardhura nga hoteleria	400	155
3	Të ardhura nga shërbimet (pritje në përcjellje)	40,000	34,273
4	Subvencioni i shtetit	220,000	270,000
5	Të ardhura nga shërbimet e eventeve (pritje në përcjellje)	35,000	35,221
6	Subvencion i shtetit me destinacion	0	0
7	Të ardhura nga punime dhe shërbime të tjera (parkime)	7,113	6,926
8	Kuota pjesë e subvencionit për investimet	48,000	29,850
9	Të ardhura nga burime të tjera	7,400	6,714
	TOTALI	431,413	414,917

Burimi: DSHQ

Nga analiza e zërave të treguesve në tabelën e të ardhurave rezulton se:

Të ardhurat nga zëri qira për vitin 2021 janë realizuar në vlerën 31,778 mijë lekë, ose 41,722 mijë lekë më pak se planifikimi. Megjithatë realizimi i këtij zëri është në masën 43.2% të parashikimit, krahasuar me vitin paraardhës kemi një rritje prej 6,582 *mijë lekë më shumë* si rezultat i përmirësimit të situatës së pandemisë botërore të virusit Covid-19 në 6 muajin e dytë të vitit 2021. Lejimi i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme, ka ndikuar në dhënien me qera të Pallatit të Kongreseve apo në organizimin e eventeve të ndryshme në Pallatin e Brigadave. Duke qenë se këto dy ambiente, gjenerojnë të ardhurat kryesore për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, ndikimi është i ndjeshëm.

Të ardhurat nga hoteleria janë parashikuar në 400 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 155 mijë lekë ose 38.8 % e planit.

Të ardhurat nga zëri Shërbime (pritje-përcjellje) për vitin 2021 janë realizuar në masën 85.7% të planit, përkatësisht në vlerën 34,273 mijë lekë. Në krahasim me vitin e kaluar ky zë është rritur me 6,134 *mijë lekë më shumë*. Kjo gjë ka ardhur si rezultat i përmirësimit të performancës së shërbimeve duke realizuar në kohë dhe me standard të lartë cilësie, shërbimet ndaj institucioneve të larta qendrore me prioritet tre Krerët e Shtetit ka sjellë rritjen e zërit për këtë të ardhur.

Të ardhurat nga subvencioni i shtetit për shpenzime korrente. Në këtë zë përfshihen të ardhurat që shteti i jep në formën e subvencionit për përballimin e shpenzimeve kryesisht të pagave dhe sigurimeve shoqërore për ato njësi ose sektorë që nuk gjenerojnë të ardhura. Për vitin 2021, është dhënë në formën e subvencionit për shpenzimet korrente vlera prej 200,000 mijë lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2021 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë akorduar fonde shtesë sipas VKM Nr.416 datë 08.07.2021 në vlerën 20 milion lekë dhe me anë të Aktit Normativ Nr.34 datë 03.12.2021 në vlerën 50 milion lekë. Në total nga buxheti i shtetit janë çelur 70 milion lekë fonde shtesë për shpenzime operative të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

Të ardhurat nga punime dhe shërbimet të tjera (parkimet & delegacionet) për vitin 2021 janë realizuar në shumën prej 6,926 mijë lekë. Krahasuar me parashikimin, i cili ishte në vlerën 7,113 mijë lekë, kemi një realizim të planit në masën 97.4%.

Të ardhura nga kuota pjesë e subvencionit për investime janë realizuar në vlerën prej 29,850 mijë lekë, ose 2,205 mijë lekë më pak se planifikimi. Kryerja e investimeve kryesisht në fund të vitit 2021 ndikon në vlerën e kuotës pjesë. Këto të ardhura nuk pasqyrojnë direkt aktivitetin e DSHQ-së, por ndikojnë në rezultatin e institucionit.

Të ardhurat nga zëri Të ardhura nga burime të tjera janë planifikuar në vlerën prej 7,400 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 6,714 mijë lekë, ose 90.7% e planit. Në krahasim me vitin e kaluar ky zë është realizuar 4,190 *mijë lekë më shumë* se realizimi i vitit 2020. Kjo për arsye të rritjes së numrit të aktiviteteve të organizuara në ambientet në përdorim nga DSHQ-së, Akt-Marrëveshjeve me subjekte shtetërore dhe private për dhënien me qira të ambienteve të jashtme të Pallatit të

Brigadave.

Të ardhura nga shërbimet, eventet (pritje – përcjellje), janë të gjitha të ardhurat e krijuara nga aktivitet dhe eventet e organizuara nga Drejtoria e Eventeve Qeveritare Publike dhe Jopublike për vitin 2021 është në vlerën 35,221 mijë lekë. Krahasuar me parashikimin e këtij zëri kemi një tejkalim të planit prej 221 mijë lekë më shumë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i përmirësimit të performancës së shërbimeve duke realizuar në kohë dhe me standart të lartë cilësie. Referuar kushteve në të cilat ndodhemi, mund të themi se të ardhurat e realizuara në këtë zë janë në nivele të kënaqshme.

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e raporteve të monitorimit 12-mujore
Situata	- Nga auditimi konstatohet se, për vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 12-mujore të buxhetit. DSHQ financohet nga buxheti i shtetit për llogarinë 603-Subvencione dhe llogarinë 231-Investime. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që DSHQ bën me Kryeministrinë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, <i>óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreó</i>. - Grupi i auditimit konstatoi se institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar. Në programin ekonomik të secilit vit, institucioni ka bërë parashikimin dhe ka vendosur objektivat vetëm për vitin pasardhës, dhe jo për një periudhë afatmesme, duke mos përcaktuar objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave.
Kriteri:	Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 <i>óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó</i>; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 <i>óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëó</i>, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, <i>óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreó</i>; Udhëzimi i MF nr.2, datë 06.02.2012 <i>óPër procedurat standard të zbatimit të buxhetitó</i>.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit nuk bën të mundur ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar nga institucioni
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	- DSHQ të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 12-mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore. - DSHQ të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe bazën e objektivave, të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria Ekonomike.

2.2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit nr.380/1 datë 12.04.2022, mbi óAuditimin Financiar dhe Përputhshmërisë në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare (DSHQ)ó, është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1)Struktura organizative e DSHQ-së;
- 2)Vendimet për emërimet, largimet dhe zbatimin strukturave organizative, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021;
- 3)Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- 4)Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;
- 5)Listëpagesat mujore dhe librat e pagave për periudhën 01.01.2019 - 31.03.2022.

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Struktura organizative

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në varësi të Kryeministrit, me seli qendrore në Tiranë, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr.7582 datë 03.07.1992 óPër ndërmarrjet shtetëroreó, i ndryshuar.

Organika dhe struktura e DSHQ-së përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit, me propozim të Këshillit Drejtues të DSHQ.

DSHQ është krijuar me VKM nr.34 datë 07.01.1999 óPër Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Lartaó, i ndryshuar.

Struktura e DSHQ-së e planifikuar dhe realizuar për periudhën objekt auditimi është si më poshtë vijon:


<i>Viti</i>	<i>Struktura sipas Viteve</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt Janar</i>	<i>Fakt Dhjetor</i>	<i>Diferenca</i>
2019	Punonjës në organikë	270/271	259	261	10
2020	Punonjës në organikë	271	261	254	17
2021	Punonjës në organikë	271	253	260	11

Burimi: DSHQ

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:


DSHQ deri më 05.11.2019, ka kryer funksionet e saj me 270 punonjës, duke u bazuar në organigramën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 133, datë 31.08.2018, óPër miratimin e organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritareó. Sipas kësaj strukture, DSHQ është e organizuar mbi bazën e 6 drejtorive si Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Eventeve Qeveritare Publike dhe Jopublike, Drejtoria e Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca, Drejtoria e Shërbimeve dhe Udhëtimeve Shtetërore, si dhe Sektorit të Auditit të Brendshëm, të varur direkt nga Drejtori i Përgjithshëm i DSHQ-së.

Organigrama e DSHQ-së ka funksionuar si më poshtë:



Me hyrjen në fuqi të Urdhrit të Kryeministrit me nr.149 datë 05.11.2019, òPër miratimin e organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritareò, numri total i punonjësve do të jetë gjithsej 271 punonjës. Sipas kësaj strukture, është shtuar me një numri total i punonjësve, dhe Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme në Kryeministri ka kaluar nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Udhëtimeve Shtetërore, në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Organigrama e DSHQ-së ka funksionuar si më poshtë:



b. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna

Emërimet

Procedura e rekrutimit të stafit në DSHQ është realizuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 óKodi

i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 14 datë 27.11.2013, për Rregulloren e Brendshme, emërimi dhe largimi nga detyra për Drejtorët e Drejtorive, specialistët dhe nivelet e tjera të punëmarrësve bëhet nga Drejtori i DSHQ-së. Pas zhvillimit të bisedimeve dhe marrjes në intervistë të subjekteve të cilët plotësojnë kriteret për punësim në institucion, dhe daljes së aktit të Emërimit në Detyrë, midis punëmarrësit dhe DSHQ-së lidhet Kontratë Individuale e Punës, e cila hartohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, me afat të caktuar 1 (një) vjeçar ku punëmarrësi i nënshtrohet një periudhe prove prej 3 muajsh.

Në përfundim të afatit të Kontratës Individuale të Punës, nga Sektori i Burimeve Njerëzore, njoftohet punonjësi dhe kryhen bisedimet për rinovimin e saj. Pas vlerësimit të performancës së punonjësit si dhe dakordësinë e të dyja palëve kryhet rinovimi i Kontratës Individuale e Punës me afat të caktuar 1 (një) vjeçar.

Kur midis punëmarrësit dhe DSHQ lidhen tre Kontrata Individuale të Punës të njëpasnjëshme, Kontrata e fundit lidhet me afat të pa caktuar. Çdo ndryshim i kushteve të Kontratës Individuale të Punës realizohet nëpërmjet një aneks kontrate e nënshkruar nga të dyja palët.

DSHQ, në bashkëpunim me Kryeministrinë, dhe DAP, bazuar në VKM nr. 586, datë 30/08/2019, "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore" për vitin 2019 ka punësuar dhe lidhur Kontrata Individuale Pune për dy punonjës.

Për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, në DSHQ janë emëruar gjithsej 49 punonjës.

Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020, në DSHQ janë emëruar gjithsej 30 punonjës.

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, në DSHQ janë emëruar gjithsej 33 punonjës.

Largimet

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, në DSHQ i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 43 punonjësve, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	25	58%
Përfundon Kontrata	7	16%
Dalje në pension	6	14%
Zgjidhje kontrate	4	9%
Dalje në KEMP	1	2%
Totali	43	

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në DSHQ i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 36 punonjësve, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	25	69%
Dalje në pension	9	25%
Largim nga puna	1	3%
Vdekur	1	3%
Totali	36	

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në DSHQ i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 27 punonjësve, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	21	78%
Dalje në pension	6	22%
Totali	27	

Për periudhën 01.01.2022-31.03.2022, në DSHQ i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 16 punonjësve, për arsyt e mëposhtme:

Arsyeja	Nr. i punonjësve	Përqindja
Dorëheqje	14	88%
Dalje në pension	2	12%
Totali	16	

Vendimet gjyqësore

Sa i takon marrëdhënieve të punës, për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 në 31.03.2022 është një çështje gjyqësore në proces gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk ka asnjë vendim të formës së prerë.

c. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve

Dosjet e personelit

Grupi i auditimit ka konstatuar se dosjet e personelit administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore duke u bazuar në VKM nr.117, datë 05.03.2014 për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, e cila përcakton se:

1. *Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*
2. *Në kuptim të këtij vendimi, me “institucione të administratës shtetërore” kuptohen Kryeministria, aparatet e ministrive, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, degët territoriale, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, administrata e prefektit, si dhe agjencitë autonome, me përjashtim të institucioneve, për të cilat, sipas ligjit të tyre të posaçëm, të dhënat e personelit konsiderohen konfidenciale.*

Sa i përket dokumenteve që duhet të jenë në dosjet e të punësuarve, baza ligjore në fuqi përcakton se:

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

-Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar.

-Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes.

-Dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit e që vërtetojnë pohimin e bërë në fletën prezantuese janë, si më poshtë vijon: fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftim ose pasaportë); certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare; dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës (diploma apo dokument tjetër i njohur ligjërisht). Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; listë e notave, nëse “nota mesatare” është kriter për punësimin në atë pozicion pune. Në rastin kur arsimimi është kryer jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; dokument i laurimit me gradë shkencore apo tituj shkencorë. Në rastin kur gradat apo titujt shkencorë janë përfituar jashtë vendit, duhet të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës; dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; akti i emërimit në pozicionin e punës; akti i dhënies së masës disiplinore; librezat e punës; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noter.

Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 20 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi.

Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion si më poshtë:

- dosjet e personelit shoqërohen nga fleta e inventarit, e cila në të gjitha dosjet është e pafirmosur nga i punësuarit dhe nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore;
- në 14 dosje mungon raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e

kontrollit mjekësor bazë;

- në 5 dosje dëshmitë janë të panoterizuara.

Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 óPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit , VKM nr. 117 datë 5.03.2014 óPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.

Marrëdhëniet e pagave

Në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit të Punës, Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me zgjedhje listëpagesat e muajve Tetor, Nëntor, Dhjetor 2019; Tetor, Nëntor, Dhjetor 2020, Janar, Shkurt, Dhjetor 2021 si dhe Janar, Shkurt 2022. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përlllogaritjet e dhënia e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi. Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se janë shoqëruar me listëprezencat në punë, të përgatitura nga Drejtorët e çdo Drejtorie dhe përgjegjësit respektivë, si dhe janë nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, si dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Në sektorin e financës dhe kontabilitetit, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 óPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 óPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 óPër tatimin mbi të ardhurat.

Titulli i gjetjes	<i>Mangësi në menaxhimin e Burimeve Njerëzore</i>
Situata:	Auditimi i kryer për dosjet e personelit është bazuar në metodën me përzgjedhje, ku janë përzgjedhur 20 dosje të cilat janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi. Gjatë auditimit të dosjeve të kampionuara të personelit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi në dokumentacion si më poshtë: - dosjet e personelit shoqërohen nga fleta e inventarit, e cila në të gjitha dosjet është e pafirmosur nga i punësuar dhe nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore; - në 14 dosje mungon raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë; - në 5 dosje dëshmitë janë të panoterizuara. Në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 óPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit , VKM nr. 117 datë 5.03.2014 óPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, dokumentacioni në dosjet e personelit nuk është i plotë.
Kriteri:	- VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit; - VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i bazës ligjore në fuqi sjell që dokumentacioni në dosjet personale të punonjësve nuk është i plotë
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturës së Burimeve Njerëzore
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Spektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa nga për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas bazës ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria Administrative, Spektori i Burimeve Njerëzore.

2.3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE

Në zbatim të pikës nr. 4 të programit të auditimit nr. 380/1 prot., datë 12.04.2022, mbi Auditimin financiar e përputhshmërisë në DSHQË, u shqyrtua dokumentacioni si mëposhtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-pagesa;
 - Transaksionet e llogarive bankare ;
 - Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme;
 - Komisionet e ngritura për inventarizimin, jashtë përdorimit të materialeve dhe asgjësimin e tyre.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.)konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuar në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 janë në vlerën totale 418,194,275 lekë;
- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuar në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 janë në vlerën totale 429,131,879 lekë;
- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuar në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 janë në vlerën totale 354,716,486 lekë.
- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuar në ditarin e bankës për periudhën 01.01.2022-31.03.2022 janë në vlerën totale 111,745,137 lekë.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër pagesave të realizuara në muajt Qershor, Korrik, Nëntor të vitit 2019; Gusht, Tetor, Nëntor të vitit 2020; Prill, Maj, Korrik të vitit 2021 dhe muaji Shkurt 2022. Grupi i auditimit përzgjodhi këto muaj pasi kanë përqindjen më të lartë të shpenzimeve mujore ndaj totalit.

Urdhër Pagesat e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik* veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si: *dokumentet autorizues, dokumentet vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi rezultoi:

- Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.
- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dokumentet autorizues, dokumente vërtetues, Dokumentet të kontabilitetit, etj.
- Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë u përdorën teknikat e auditimit si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas

një treguesi.

Për vitin 2019 në DSHQ janë Zhvilluar 23 procedura prokurim me vlerë të vogël , me vlerë të kontratave 9,825,656 leke;

Për vitin 2020 në DSHQ janë Zhvilluar 15 procedura prokurim me vlerë të vogël , me vlerë të kontratave 4,909,070 leke;

Për vitin 2021 në DSHQ janë Zhvilluar 17 procedura prokurim me vlerë të vogël , me vlerë të kontratave 4,327,051 leke.

b. Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

- U audituan me zgjedhje dokumentacioni i magazinës për vitin 2019, 2020 dhe 2021. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publikó*, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina behej me programin Financa 5.

Fletë hyrje dhe fletë dalje, ndjekin rendin kronologjik, ku ka adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli.

Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; Shkresën e Njesisë për transferimin e aktiveve;

- Për hyrjet e aktiveve të dhuruara rezultoi se dokumentacioni shoqërues përbëhej nga fatura që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Procesverbali i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve, si dhe është bashkëngjitur kontrata e grandit së njësisë donatore.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Në përputhje me Vendimin nr.34, datë 07.01.1999 *óPër Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e Personaliteteve të Lartaó*, të ndryshuar, dhe në bazë të VKM Nr. 1058, datë 16.07.2008, *óPër miratimin e listës së inventarit të pronave pasuri të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministraveó* për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare administron një numër pronash të cilat janë në pronësi të shtetit të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave. Këto prona në bazë të legjislacionit në fuqi janë në dispozicion për shfrytëzim nga 3 Krerët e Lartë të Shtetit, Presidentit të Republikës, Kryetarit të Parlamentit dhe Kryeministrit. Gjithashtu në zbatim të VKM nr.34 datë 07.01.1999 i ndryshuar, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund ti japë me qira disa nga pronat që ka në administrim.

Në vijim po pasqyrojmë pronat në administrim, në rrethin Tiranë, Durrës, Vlorë, Pogradec, Gjirokastrë, Lushnjë dhe Shkodër.

Pronat e administruara nga DSHQ në rrethin e Tiranës janë:

-*Pallati i Kongreseve*, i cilika njësipërfaqe totale e objektit 23,709.7 m². Mjedisi kryesor i Pallatit të Kongreseve është Salla e Koncerteve prej 2040 vendesh e kompozuar për të plotësuar kërkesat funksionale, artistike dhe akustike për zhvillimin e kongreseve, konferencave e koncerteve. Për veprimtari të ndryshme shfrytëzohen edhe tre salla me kapacitete 150, 280 dhe 300 vende. Aktualisht në ambientet e Pallatit të Kongreseve ushtrojnë aktivitetin administratat e institucioneve, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia për Media dhe Informim dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu Salla B Underground shfrytëzohet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për zhvillimin e seancave dëgjimore dhe seancave të dhënies së vendimeve. Ky objekt është në funksionalitet të plotë.

-*Pallati i Brigadave*, i cilika njësipërfaqe totale të pronës 395,000 m². Pallati i Brigadave është objekt i cili funksionin kryesor e ka shfrytëzimin për organizimin e pritjeve, mbledhjeve, dhe aktiviteteve të ndryshme të tre Krerëve të Lartë të Shtetit. Gjithashtu subjekte të ndryshme publike dhe private mund të marrin më qira ambientet e brendshme dhe të jashtme të Pallatit të Brigadave si dhe Parkun e Pallatit për organizimin e eventeve përkatëse. Ky objekt është i përbërë nga 3 kate dhe një kat underground. Në katin e parë ndodhen Salla e Skënderbeut, Salla e Dritareve dhe Salla e Tavolinave të Rrumbullakëta gjithashtu dhe ambiente zyresh, bibliotekë etj. Në katin e dytë ndodhen 3 apartamente dhe në katin e tretë janë disa dhoma. Ky objekt është në funksionalitet të plotë.

-*Vila nr.4* është objekt, Rezidence Qeveritare i dedikuar Presidentit të Republikës me një sipërfaqe totale ndërtese 1035.50 m².

-*Vila nr.5*, e cila ka një sipërfaqe totale ndërtese prej 2688.98 m², është vilë në afërsi të Vilës nr.4, vetëm karabina, dhe aktualisht është jashtë funksionit.

-*Kisha e Pallatit të Brigadave* është e vendosur në mjediset e brendshme të kopshteve të Pallatit të Brigadave.

-*Magazina* me sipërfaqe totale të magazinës nr.1: 966.91 m², sipërfaqe totale të magazinës nr.2: 189.52 m², sipërfaqe totale të pronës: 1156.43 m².

-*Vila 30* ka njësipërfaqe totale të ndërtesës 2,316.53 m², Sipërfaqe totale të pronës 8,435.20 m². Kjo vilë është objekt, Rezidence Qeveritare e dedikuar për Kryeministrin e Shqipërisë. Vila ka një territor përreth i cili përfshin serrën, magazinë ushqimore dhe garazhe. Ky objekt është në funksionalitet të plotë.

-*Vila 31* ka sipërfaqe të ndërtesës 4144.93 m² dhe sipërfaqe totale të pronës 6559.31 m², e cila përdoret për aktivitete të ndryshme zyrtare, por edhe privatë përkundrejt pagesës, dhe dy kate janë apartamente banimi. Vila 31 është në funksionalitet të pjesshëm.

-*Bar Restorant Tiranaka* një sipërfaqe totale të pronës 474 m². Në bazë të VKM nr.54 datë 5.2.2014 për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, kjo pronë mund të jepet me qira të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose enfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit me plotësimin e kriterëve sipas legjislacionit në fuqi.

-*Parku i Delegacioneve* ka sipërfaqe totale të ndërtesës 2,393.24 m² dhe sipërfaqe totale të pronës 6087.52 m². Me VKM nr.1058 datë 16.07.2008 për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për DSHQ, pasqyrohet dhe Qendra e Transportit/ Parku i Delegacioneve si një ndër pronat në administrim të institucionit. Referuar VKM nr.34 datë 07.01.1999 i ndryshuar, objekti i veprimtarisë së Parkut të Delegacioneve nëpërmjet automjeteve që disponon, është transporti i delegacioneve të huaja që priten nga Kuvendi, Presidenca, Këshilli i Ministrave, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore. Këto institucione për shërbime të këtij lloji shfrytëzojnë automjete të Parkut të Delegacioneve. Parku i Delegacioneve kryen dhe shërbime të tjera transporti personash, të kërkuara nga subjekte shtetërore. Gjithashtu mjediset e Parkut të Delegacioneve, shfrytëzohen dhe nga subjekte private për parkimin e automjeteve personale. Ky objekt është në funksionalitet të plotë.

-*Vilat Gjermane* përfshijnë 6 (gjashtë) objekte dhe truallin përkatës, me sipërfaqe totale prone 5340.00 m²

Bazuar në Vendim Nr. 637, datë 26.10.2018 për dhënien në përdorim, pa shpërblim, nga DSHQ te Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, ambjentet e dy vilave gjermane janë dhënë në përdorim, pa shpërblim, nga DSHQ te Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për një afat të pacaktuar, me qëllim shfrytëzimin e tyre si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative. Këto objekte janë në funksionalitet të plotë. Vilat nr.1-2-3-4, janë aktualisht jashtë funksionit.

-*Apartamentet e ish-Presidentëve të Republikës*: Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, është në

administrim të pronës së paluajtshme shtetërore, prej 6 (gjastë) apartamentesh me sipërfaqe totale 578,2 m² të ndodhura në godinën nr. 57, në bulevardin óZogu Ió, Tiranë, për tóua dhënë në përdorim dhe pa shpërblim, si mjedise pune, ish-presidentëve të Republikës së Shqipërisë.ó Nga këto apartamente 3 (tre) janë në shfrytëzim nga ish-Presidentet e Republikës. Këto objekte janë në funksionalitet të plotë.

-Vilat Dajt

Vila nr.1 Dajt, ka këto përmasa: Sipërfaqe totale e ndërtesës: 1206.55 m², e cila është në funksionalitet të plotë.

Vila nr.2 Dajt, ka këto përmasa: Sipërfaqe totale e ndërtesës: 428.32 m², aktualisht është jashtë funksionit.

Pronat e administruara nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në rrethin Vlorë janë:

-Vila nr.1 Vlorë mesipërfaqe totale ndërtese 2374.18 m² dhe sipërfaqe totale të pronës 62,675 m².Kjo vilë është në funksionalitet të plotë.

-Vila nr.2 Vlorë dhe objekti “Magazina Ushqimore” dhe “Kaldaja” mesipërfaqe totale ndërtese 3415.55 m², sipërfaqja e objektit magazina ushqimore: 864.75 m², sipërfaqja e objektit Kaldaja: 68.75 m².Kjo vilë ka qenë në përdorim para viteve 1990. Kapaciteti i vilës është 6 dhoma dopio dhe 5 dhoma teke. Aktualisht është jashtë funksionit.

*-Vila nr. 6 Vlorë*mesipërfaqe totale të ndërtesës 883.31m² dhe sipërfaqe totale të pronës: 86,910.80 m², e cila aktualisht është jashtë funksionit.

*-Vila nr. 9 Vlorë*me sipërfaqe totale të ndërtesës 419.03 m² dhe sipërfaqe totale të pronës: 86,911 m², e cila aktualisht është jashtë funksionit.

-Vila Dhërmika sipërfaqe totale ndërtese 940.21 m², sipërfaqe totale të pronës 5264.70 m². Kjo vilë është në funksionalitet të plotë.

-Pronat e administruara nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në rrethin Durrës janë:

Vila nr.6 me sipërfaqe ndërtese 620.65 m²; *Vila nr.13* me sipërfaqe ndërtese prej 378.40 m², e sipërfaqe totale të pronës 2930.30 m²; *Vila nr.20* me sipërfaqe ndërtese prej 464.32 m²; *Vila nr.5* me sipërfaqe ndërtese prej 305.21 m²; *Vila nr.29* me sipërfaqe prej 232.73 m²; *Vila nr.30* me sipërfaqe 246.80 m²; *Vila nr. 23* me sipërfaqe totale 604.56 m²; Reparti Ushtarak me këto përmasa: Sipërfaqe totale e objektit 1012.45 m²; *Godina e Zyrave* me këto përmasa: Sipërfaqe totale e ndërtesës 139.90 m²; *Kabina elektrike* me këto përmasa: Sipërfaqe totale e objektit 172.21 m²; *Zdrukhëtaria* me këto përmasa: Sipërfaqe totale e objektit 139.90 m²; Sipërfaqja funksionale e Klub Stabilimenti, me sipërfaqe totale trualli 1984 m²; si dhe *Vila 6* është në shfrytëzim të Presidentit të Republikës, *Vila 13* është në shfrytëzim të Kryeministrit ndërsa *Vila 20* shfrytëzohet nga Kryetari i Parlamentit. Këto objekte janë në funksionalitet të plotë.

- *“Ish-Shtëpia e Pritjes” Gjirokastrë* ka sipërfaqe totale të pronës 4000 m², sipërfaqe totale e ndërtesës 702 m² administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

- *Qendra Rezidenciale Pogradec* ka 4 vila, dhe ka një sipërfaqe totale të pronës prej 36,722.39 m².

- *Vila Divjakë* ka një sipërfaqe ndërtese prej 508.55 m², sipërfaqe totale të pronës prej 4208 m².

Vila momentalisht është jashtë funksionit.

- *Vila në Velipojë* ka sipërfaqe ndërtese prej 1045.93 m² dhe ², sipërfaqe totale të pronës 8707 m². *Vila* momentalisht është jashtë funksionit.

Inventarizimi i pronës

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó*. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u auditua inventarizimi i zyrave të DSHQ-së si dhe Pallati i Kongreseve, nga ku ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó*, neni 26 ku citohet: *óÇdo njësi publike duhet të krijojë dhe të*

përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës.

Për vitin 2019, DSHQ ka ngritur komisionin me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 5760 datë 20.11.2019 për ngritjen e komisionit për inventarizimin për vitin 2019 dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.

Në relacionin 6106/1 prot., datë 26.12.2019 me lëndë mbledhëse rezultatat e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët në zyrat e DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, komisioni mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e inventarit dhe bëri verifikimin fizik sasior dhe cilësor të të gjithë materialeve aktive, nga i cili rezultoi se materialet gjendje në ngarkim të specialistit të fonisë, me një vlerë prej 1,308,272.1 lekë, janë materiale fonie të ndryshme të Pallatit të Kongreseve të cilat nuk mund të përdoren më, si pasojë e zhvillimit të teknologjisë. Grupi i inventarizimit ka propozuar ngritjen e një komisioni teknik për vlerësimin e aktiveve.

Për vitin 2020, DSHQ ka ngritur komisionin me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 375, datë 03.11.2020 për ngritjen e komisionit për inventarizimin për vitin 2020 dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.

Në relacionin nr. 3884/1 prot. datë 23.11.2020 me lëndë mbledhëse rezultatat e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët në zyrat e DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, komisioni mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e inventarit dhe bëri verifikimin fizik sasior dhe cilësor të të gjithë materialeve aktive, nga i cili rezultoi si në vitin 2019, materialet gjendje në ngarkim të specialistit të fonisë, me një vlerë prej 1,308,272.1 lekë, janë materiale fonie të ndryshme të Pallatit të Kongreseve të cilat nuk mund të përdoren më, si pasojë e zhvillimit të teknologjisë. Grupi i inventarizimit ka propozuar ngritjen e një komisioni teknik për vlerësimin e aktiveve.

Për vitin 2021, DSHQ ka ngritur komisionin me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1660, datë 05.11.2021 për ngritjen e komisionit për inventarizimin për vitin 2021 dhe ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit.

Në relacionin nr. 1660/1 prot. datë 23.11.2021 me lëndë mbledhëse rezultatat e inventarizimit të orendi pajisjeve dhe inventarit të imët në zyrat e DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, nga komisioni i inventarizimit ka rezultuar se nuk ka diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet.

Grupi i auditimit ka konstatuar se, sa i takon zyrave të DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit në raportin përfundimtar, janë evidentuar aktive të cilat konsiderohen si jashtë përdorimit për shkak të ndryshimit të teknologjisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, i ndryshuar, pika 96 e procesit të vlerësimit të aktiveve është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.”

Duke qenë se nuk është ngritur asnjë komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara, pas nuk janë ndjekur proceset e vlerësimit të aktiveve dhe rrjedhimisht dhe të daljes jashtë përdorimit nëse konstatohen aktive të dëmtuara.

Titulli i gjetjes:	Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara nga institucioni.
Situata:	- Nga auditimi i dosjes së inventarizimit u konstatua se sa i takon zyrave të DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit në raportin

	përfundimtar, janë evidentuar aktive të cilat konsiderohen si jashtë përdorimit për shkak të ndryshimit të teknologjisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, i ndryshuar, pika 96 ë “Procesi i vlerësimit të aktiveve është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.”</i>
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.</i>
Ndikimi/Efekti:	Risku i monitorimit të gjendjes reale të aseteve në institucion.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor, lidhur me hapat që duhen ndjekur gjatë procesit të kryerjes së inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i institucionit të DSHQ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komision i Inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Drejtoria Ekonomike.

2.4. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i pasqyrave financiare.
- Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.
- Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
- Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.
- Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në varësi të Kryeministrit, me seli qendrore në Tiranë, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr.7582 datë 03.07.1992 *“Për ndërmarrjet shtetërore”,* i ndryshuar.

DSHQ e ka organizuar mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, në zbatim të Ligjit nr. 25/2018 *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”,* si dhe në zbatim të nenit 5, pika 2 e ligjit, DSHQ ka zbatuar SNRF-të për hartimin e pasqyrave financiare.

Sistemi kontabël i shoqërisë është i organizuar mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në lekë, si monedha funksionale e shoqërisë. Transaksionet në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale (lekë) me kursin e datës në të cilën ndodh transaksioni.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019 dhe vitin 2020 janë të shoqëruara me Pasqyrën e Pozicionit Financiar, me Pasqyrën e Performancës, Pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, Pasqyrë e ndryshimit të kapitalit, si dhe shënimet sqaruese përkatëse mbi pasqyrat financiare.

Këshilli Drejtues me vendimin nr. 21, datë 14.07.2021 *“Për miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2020”* ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2020, pas ekspertimi ligjor të llogarive vjetore të realizuara nga audituesit ligjore të caktuar nga struktura përgjegjëse.

Pasqyrat financiare janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë nëpërmjet sistemit C@ts, duke respektuar kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar, pika

3.12. óDeklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit në lidhje me depozitim on-line të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës, të shoqëruara këto me deklaratën vjetore të tatimit mbi fitimin.

Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata të qëndrueshme të trupëzuara, zëri *ótoka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, aktive në proces* paraqiten me koston e tyre historike minus amortizimin e akumuluar, përveç tokës e cila pasqyrohet me koston e blerjes dhe aktiveve në proces.

Kosto historike e aktiveve përfshin koston e blerjes si dhe të gjitha kostot shtesë që lidhen me vendosjen e aktivitet në gjendje pune, apo edhe kosto të përmirësimit të jetës së aktivitet të ndodhura gjatë jetës së tij të dobishme.

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten në bilanc me vlerën e tyre kontabël neto 3,519,564,452 lekë. Amortizimi i aktiveve është llogaritur me metodën lineare në mënyrë që kosto e çdo aktivitet deri në vlerën e mbetur të shpërndahet përgjatë gjithë jetës së tij të dobishme. Në pasqyrën e të ardhurave, amortizimi me norma fiskale për vitin 2021 është paraqitur si zë i shpenzimeve më vete për shumën 69,813,270 lekë.

DSHQ nuk ka kryer rivlerësim të aktiveve në kundërshtim me kërkesat e Standardeve Evropiane të Vlerësimit, Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe konkretisht SNK16 óAktivitet Afatgjata Materiale dhe SNK36 óZhvlerësimi i Aktiveve. Në kushtet kur nuk është kryer një rivlerësim i aktiveve, nuk mund të përllogaritet efekti i rregullimeve të nevojshme që mund të bëheshin në lidhje me vlerësimin e tyre me vlerën e drejtë për periudhën që është mbyllur me datë 31 dhjetor 2021. Drejtoria duhet të shikojë mundësinë e rivlerësimit të aktiveve afatgjata me vlerën e drejtë.

Analiza e posteve kryesore të bilancit:

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, llogaritë e Aktivitet dhe të Pasivitet kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2021 në *Aktivitet e Bilancit Kontabël* rezulton se:

- Më datë 31.12.2021 óAktivitet afatgjata zënë 91 % të vlerës totale të aktivitet, ndërsa óAktivitet Afatshkurtra zënë 9% të totalit.

Aktivitet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

<i>Aktive afatshkurtra</i>	<i>Viti 2021</i>	<i>Viti 2020</i>
Mjete monetare	128,613,179	90,288,752
Te drejta të arkëtueshme		
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	120,634,424	95,573,708
<i>Te tjera</i>	44,118,318	37,494,619
Inventarët	38,633,411	47,106,599
Totali i aktiveve afatshkurtra	331,999,333	270,463,677
<i>Aktive afatgjata</i>		
Aktive materiale		
<i>Toka dhe ndërtesa</i>	3,337,362,905	3,295,820,430.16
<i>Impiante dhe makineri</i>	94,690,095	115,203,445.04
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	87,511,452	85,925,416.91
Totali i aktiveve afatgjata	3,519,564,452	3,496,949,292.11

Burimi: DSHQ, përpunuar nga grupi i auditimit

Inventarët në fund të vitit 2021 paraqiten në shumën 38,633,411 lekë. Në krahasim me vitin 2020, janë ulur në vlerën 8,473,187 lekë.

Llogaria óToka dhe Ndërtesa paraqitet në shumën 3,337,362,905 lekë, ku përfshin të gjitha tokat dhe ndërtesat në pronësi të DSHQ-së, të cilat janë rritur në vlerën 41,542,475 lekë nga viti i

mëparshëm.

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2021 në *Pasivin e Bilancit Kontabël* rezulton se Detyrimet afatshkurtra zënë 100% të detyrimeve.

<i>Detyrime afatshkurtra</i>	<i>Viti 2021</i>	<i>Viti 2020</i>
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	70,292,722	31,391,943
Te pagueshme për detyrime tatimore	2,284,833	2,266,254
Te tjera te pagueshme	2,104,458	2,350,978
Te pagueshme për shpenzime të konstatuara		
Te ardhura të shtyra	467,868,368	434,069,593
Provizione	29,400,000	29,400,000
Totali i detyrimeve afatshkurta	575,726,969	503,165,190
Detyrime afatgjata	0	0
Detyrime totale	575,726,969	503,165,190

Burimi: DSHQ, përpunuar nga grupi i auditimit

Në pasqyrën e pozicionit financiar të DSHQ trashëgohet në vite një provizion, i lidhur me kërkesat e arkëtueshme në vlerën 29,400,000 lekë, baza metodologjike për llogaritjen e te cilit nuk është e qartë. Kjo shumë mund të përdoret nga DSHQ për të mbuluar disa nga kërkesat e arkëtueshme afatgjata pa shpresë arkëtimi, pasi të jenë kryer më parë të gjitha procedurat e duhura ligjore.

Analiza e llogarisë “Klientë për mallra, produkte e shërbime”

Disa nga klientët e paarkëtuar që zënë peshën specifike më të madhe më 31.12.2021 janë:

<i>Nr.</i>	<i>Klienti</i>	<i>Shuma</i>
1	Iliria Holding	17,295,728.30
2	Klientë të dyshimtë	10,034,188.00
3	Fiera del Levante	3,668,078.42
4	Ministria e Kulturës	4,928,296.00
5	Ministria e Punëve të Jashtme	1,735,246.00
6	Garda e Republikës	1,507,952.00
7	Ministria e Mbrojtjes	1,854,219.00
8	Kryeministria	21,101,063.57
9	Presidenca	908,300.60
10	Bashkia Tiranë	1,652,583.20
11	Kuvendi	1,876,228.36
12	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	359,160.00
13	A. S .A	346,374.00
14	H.R.CE M shpk	1,046,525
15	I. C	1,701.000

Burimi: DSHQ

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare gjatë vitit 2021 ka mundur të mbledhë disa detyrimeve të viteve të mëparshme, dhe vazhdon të ndjekin në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme brenda kuadrit ligjor të klientëve debitorë.

Përgjatë vitit 2021 ka vazhduar nga ana e institucioneve likuidimi i faturave të vitit 2020.

Në 31.12.2021 kemi detyrime të ndara sipas viteve të krijimit si më poshtë:

Në mijë lekë

<i>Periudha</i>	<i>Vlera e detyrimit të klientëve kundrejt DSHQ</i>
Përpara vitit 2015	64,624
Viti 2015	1,182
Viti 2016	1,491
Viti 2017	2,527
Viti 2018	1,297

Viti 2019	7,720
Viti 2020	8,250
Viti 2021	32,700

Burimi: DSHQ

Problematiche paraqitet gjendja e disa prej klientëve të krijuar nga viti 2000 e më parë, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë të pandryshuar.

Për këto klientë ka shumë pak ose aspak shpresë për arkëtimin e tyre, pasi ka kaluar një periudhë e gjatë kohe dhe me gjithë njoftimet e herë pas herëshme nuk po mundësohet likuidimi i këtyre detyrimeve. Njoftim për likuidim të detyrimeve të prapambetura është bërë përgjatë gjithë vitit 2021 si dhe në vazhdim të vitit 2022. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është duke e ndjekur në proces gjyqësor me subjektin H.....sh.p.k dhe A.G për detyrimet e pashlyera.

Në pasqyrën e pozicionit financiar të DSHQ trashëgohet ndër vite një provizion, i lidhur me kërkesat e arkëtueshme në vlerën 29,400,000 lekë, baza metodologjike për llogaritjen e të cilit nuk është e qartë. Kjo shumë mund të përdoret nga DSHQ për të mbuluar disa nga kërkesat e arkëtueshme afatgjata pa shpresë arkëtimi, pasi të jenë kryer më parë të gjitha procedurat e duhura ligjore.

Analiza e llogarisë “Furnitorë për blerje e shërbime”.

Nga analiza e llogarisë Furnitorë për vitin 2021 rezulton se teprica e fund vitit është në vlerën 70,293 mijë lekë. Në zërin e furnitorëve, në fund të vitit 2021 është përfshirë dhe zëri ôFurnitorë për Garanciô për shumën 7,684 mijë lekë e cila përfaqëson (5%) të paguara firmave zbatuese për investimet e kryera deri në 31.12.2021. Fondet për pagesat e (5%) janë te ngurtësuar në llogarinë e bankës së thesarit.

Krahas këtij detyrimi, në fund të vitit paraqiten serish me tepricë të lartë dhe me vlerë të konsiderueshme llogaritë e furnitorëve për fatura të palikuiduara për shumë vite me radhë si më poshtë:

Disa detyrime që i përkasin viteve përpara vitit 2021:

1. Dega e Karburantit Tiranë për furnizimet me karburant në vlerën 2,904 mijë lekë
2. OSHEE (ÇEZ)ñ Tiranë për 2,786 mijë lekë;
3. T. E për shumën 1,326 mije leke;
4. V shpk për shumën 699 mijë lekë;
5. R për 350 mijë lekë;
6. Kombinati i Mishit për 312 mijë lekë
7. Firmës S... për shumën 999 mijë lekë;
8. D...& V shpk për shumën 558 mijë lekë;
9. M.... shpk për shumën 652 mijë;
10. I.... shpk për shumën 730 mijë lekë, detyrim i prapambetur nga viti 2004.

Totali i detyrimeve të mbartura përpara pesë viteve, nga viti 2015 e më parë, është në vlerën 64,624 mijë lekë.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare gjithashtu përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021, ka likuiduar të gjitha detyrimet për faturat e furnitorëve që i përket debisë së vitit 2021, si më poshtë vijon:

1. P.....Shpk 3,703 mijë lekë
2. Q..... shpk 187 mijë lekë
3. P..... 5,877 mijë lekë
4. C.c 144 mijë lekë
5. S. F 572 mijë lekë
6. L....shpk 40,85 mijë lekë
7. M.... and D..... 105 mijë lekë
8. B.... shpk 222 mijë lekë

Kapitali dhe rezervat

Kapitali dhe Rezervat	Viti 2021	Viti 2020
Kapitali i nënshkruar	3,182,936,799	3,179,785,145
Rezerva te tjera		
Rezerva ligjore	5,009,746	5,009,746
Rezerva te tjera	94,624,885	94,624,885
Fitimi/(humbja) e pashpërndarë	-15,171,998	-26,494,264
Fitimi/(humbja) e periudhës	8,437,383	11,322,266
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njësisë ekonomike	3,275,836,816	3,264,247,779
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	3,275,836,816	3,264,247,779

Burimi: DSHQ

Kapitali i nënshkruar me 31.12.2021 është në vlerën 3,182,936,799 lekë, ku në krahasim me vitin 2020 ka pësuar një rritje në vlerën 3,151,654 lekë.

Rezerva ligjore me 31.12.2021 është në vlerën 5,009,746 lekë, duke mos patur ndryshim me vitin paraardhës.

Rezerva të tjera paraqitet në shumën prej 94,624,885 lekë.

2.5. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

-Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019 në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë realizuar 124 procedura prokurimi, me vlerë totale 140,725,712 lekë pa TVSH

Ndër të cilat:

- Procedure e Hapur - Vlera e Kontratave pa TVSH në leke - 0 procedura;
- Kërkesë për propozim - Vlera e Kontratave pa TVSH në 58,741,401 leke - 23 procedura;
- Marrëveshje Kuadër (ABP) - Vlera e Kontratave pa TVSH në leke në 0 procedura;
- Negocim pa shpallje paraprake - Vlera e Kontratave pa TVSH- leke - 0 procedura;
- Prokurim me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH në 9,825,656 leke - 23 procedura;
- Blerje nën 100.000 leke - Vlera e Kontratave pa TVSH në 264,380 leke - 7 procedura;
- Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 596,375 lekë - 7 procedura;
- Ceremonial - Vlera e Kontratave pa TVSH në 72,124,762 lekë në 64 procedura;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 10 procedura kërkesë për propozim me fond limit 41,420,435 lekë pa tvsh.

-Janë audituar 12 procedura ceremonial me fond limit 45,338,840 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 62% e vlerës së procedurave të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

-Nga auditimi u konstatua për vitin 2020 në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë realizuar 76 procedura prokurimi, me vlerë totale 88,188,859 lekë pa TVSH

Ndër të cilat:

- Procedure e Hapur - Vlera e Kontratave pa TVSH në 18,922,514 leke - 1 procedurë;
- Kërkesë për propozim - Vlera e Kontratave pa TVSH në 26,421,848 leke - 7 procedura;
- Marrëveshje Kuadër - Vlera e Kontratave pa TVSH në 6,980,801 leke - 2 procedura;
- Negocim pa shpallje paraprake - Vlera e Kontratave pa TVSH në leke - 0 procedura;
- Prokurim me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH në 4,909,070 leke - 15 procedura;
- Blerje nën 100.000 leke - Vlera e Kontratave pa TVSH në 536,616 leke - 12 procedura;
- Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 573,202 leke - 8 procedura;
- Ceremonial - Vlera e Kontratave pa TVSH - 29,844,808 leke - 31 procedura;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 8 procedura prokurimi me fond limit në total 53,169,035 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 61% e vlerës së procedurave të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve

Qeveritare.

-Nga auditimi u konstatua se për vitin 2021 në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë realizuar 126 procedura prokurimi, me vlerë totale 158,114,081 lekë pa TVSH

Ndër të cilat:

- Procedure e Hapur - Vlera e Kontratave pa TVSH në 36,662,350 leke - 2 procedura;
- Procedure e Hapur e thjeshtuar - Vlera e Kontratave pa TVSH- 3,441,092 leke - 1 procedurë;
- Kërkesë për propozim - Vlera e Kontratave pa TVSH në 43,386,997 leke - 12 procedura;
- Marrëveshje Kuadër - Vlera e Kontratave pa TVSH në 20,060,344 leke - 2 procedura;
- Negocim pa shpallje paraprake - Vlera e Kontratave pa TVSH në leke - 0 procedura;
- Prokurim me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH në 4,327,051 leke - 17 procedura;
- Blerje nën 100.000 leke - Vlera e Kontratave pa TVSH në 2,348,701 leke - 43 procedura;
- Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 939,884 leke - 13 procedura;
- Ceremonial në Vlera e Kontratave pa TVSH në 49,296,359 leke - 36 procedura;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 14 procedura me vlerë 108,975,692 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 68% e vlerës së procedurave të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

U audituan procedurat si më poshtë vijon :

Viti 2019

1. Procedura e Prokurimit : óBlerje Karrigesh për vitin 2019 me fond limit 6,000,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin M.... shpk me vlerë 5,364,000 lekë pa tvsh.
2. Procedura e Prokurimit : óDetergjentë, produkte higjienosanitare dhe aksesore në ndihmë të pastrimit me fond limit 4,334,647 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin S.... me vlerë 3,600,000 lekë pa tvsh.
3. Procedura e Prokurimit : óKancelari dhe toner me fond limit 2,196,550 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin U.... P... me vlerë 2,105,730 lekë pa tvsh.
4. Procedura e Prokurimit : óMateriale elektrike me fond limit 3,540,580 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B... T..B..... me vlerë 2,938,414 lekë pa tvsh.
5. Procedura e Prokurimit : óMateriale hidraulike dhe pajisje hidrosanitare me fond limit 2,958,659 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin S.... C.. me vlerë 2,697,876 lekë pa tvsh.
6. Procedura e Prokurimit : óMateriale ndërtimi me fond limit 4,030,200 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B.... N.... me vlerë 3,839,094 lekë pa tvsh.
7. Procedura e Prokurimit : óPajisje dhe materiale elektroshtëpiake me fond limit 3,896,430 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin shpk me vlerë 3,870,000 lekë pa tvsh.
8. Procedura e Prokurimit : óPajisje orendi dhe mobilim me fond limit 4,405,720 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin U..... P..... me vlerë 4,340,000 lekë pa tvsh.
9. Procedura e Prokurimit : óPajisje, enë dhe mjete kuzhine me fond limit 4,057,649 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin U.... P..... me vlerë 3,933,100 lekë pa tvsh.
10. Procedura e Prokurimit : óShërbim Servisi për automjetet e DSHQ për vitin 2019 me fond limit 6,000,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin K..... me vlerë 4,546,150 lekë pa tvsh.

Viti 2020

1. Procedura e Prokurimit: óDetergjentë me fond limit 4,849,304 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin S.... me vlerë 4,330,090 lekë pa tvsh.
2. Procedura e Prokurimit: óMateriale elektrike për vitin 2020 me fond limit 3,540,462 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B... T.... B.... me vlerë 3,091,531 lekë pa tvsh.
3. Procedura e Prokurimit: óMateriale hidraulike dhe pajisje hidrosanitare me fond limit 2,950,738 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin R.... D.... me vlerë 2,433,021 lekë pa tvsh.

4. Procedura e Prokurimit: óMateriale ndërtimi për vitin 2020ô me fond limit 3,985,776 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B... N....me vlerë 3,567,169 lekë pa tvsh.
5. Procedura e Prokurimit : óRiparim i dyshemesë me fond limit 7,920,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin K.... C.....me vlerë 7,636,935 lekë pa tvsh.
6. Procedura e Prokurimit: óSiguricion ndërtesa, mjete transporti dhe piktura për vitin 2020ô me fond limit 3,174,891 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin A....me vlerë 3,086,001 lekë pa tvsh.
7. Procedura e Prokurimit: óBlerje Karburanteshô me fond limit 21,067,864 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin G... C.... G..... me vlerë 18,922,514 lekë pa tvsh.
8. Procedura e Prokurimit: óShërbim Servisi dhe pjesë këmbimi për automjetet e DSHQ-së për vitin 2020ô me fond limit 5,680,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin T.... A.... dhe C..... shpk me vlerë 5,668,301 lekë pa tvsh.

Viti 2021

1. Procedura e Prokurimit: óBlerje karburanti për vitin 2021ô me fond limit 21,067,864 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin G....C... G....shpk & G.... O... me vlerë 19,005,864 lekë pa tvsh.
2. Procedura e Prokurimit : óDetergjentë, produkte higjienosanitare, aksesore në ndihmë të pastrimit, pajisje mbrojtëse dhe dezinfektantë për vitin 2021ô me fond limit 5,765,104 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin S.... shpk me vlerë 5,150,300 lekë pa tvsh.
3. Procedura e Prokurimit: óHidroizolim i tarracës së Pallatit të Kongreseveô me fond limit 25,032,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B.... shpk dhe E... K.... shpk me vlerë 24,653,040 lekë pa tvsh.
4. Procedura e Prokurimit : óHidroizolim i kabanoneve dhe magazinave në parkun e delegacioneveô me fond limit 4,050,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin A....shpk me vlerë 3,900,132 lekë pa tvsh.
5. Procedura e Prokurimit: óImpiante për filtrim Ujiô me fond limit 2,400,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin T..... shpk me vlerë 1,519,750 lekë pa tvsh.
6. Procedura e Prokurimit: óMateriale elektrike për vitin 2021ô me fond limit 5,790,462 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B...t.... B.... me vlerë 4,256,457 lekë pa tvsh.
7. Procedura e Prokurimit : óMateriale hidraulike dhe pajisje hidrosanitare për vitin 2021ô me fond limit 2,700,738 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin T... shpk me vlerë 2,159,443 lekë pa tvsh.
8. Procedura e Prokurimit: óMateriale ndërtimi për vitin 2021ô me fond limit 5,404,976 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin T.... shpk me vlerë 4,349,355 lekë pa tvsh.
9. Procedura e Prokurimit : óProjekti i Hidroizolimit të tarracës së pallatit të Kongreseveô me fond limit 805,382 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin A.... me vlerë 451,622 lekë pa tvsh.
10. Procedura e Prokurimit: óRestaurimi dhe Pastrimi i Mermerëve të Fasadës së Pallatit të Kongreseveô me fond limit 5,713,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin R.... C.... me vlerë 3,441,092 lekë pa tvsh.
11. Procedura e Prokurimit: óRikonstruksion i tre zyrave të ish presidentëveô me fond limit 12,272,500 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin M....shpk & T.... shpk me vlerë 12,009,310 lekë pa tvsh.
12. Procedura e Prokurimit: óRiparimi, pastrimi dhe luçidimi i Dyshemesë së Hollit Kryesor dhe Katit të Dytë të Pallatit të Kongreseveô me fond limit 6,562,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin Pastrime S.... shpk dhe F..... shpk me vlerë 5.935,522 lekë pa tvsh.
13. Procedura e Prokurimit: óRiparim i dyshemesë së hollit në hyrjen jugore të Pallatit të Kongreseveô me fond limit 1,511,666 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin B.... shpk me vlerë 1,494,000 lekë pa tvsh.
14. Procedura e Prokurimit: óSuvatimi me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseveô me fond limit 9,900,000 lekë pa tvsh, me vlerë të kontraktuar me operatorin T.... shpk&Sh.... shpk me

vlerë 9,264,800 lekë pa tvsh.

-Nga auditimi u konstatua se të gjitha dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse **nuk** rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

-Nga auditimi u konstatua se procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, “PËR PROKURIMIN PUBLIK” :

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;

c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;

ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;

d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;

dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;

e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;

ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;

g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët , por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

1.) Procedura e Prokurimit : “Impiante për filtrim uji për vitin 2021”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Impiante për filtrim uji për vitin 2021		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.190/4, datë 01.03.2021 Njësinë e prokurimit : P. K, B. H A. D.	3. Urdhër i brendshëm nr.190/1, datë 25.01.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit me përbërje : B. T, D. T E.L	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me nr.190/6, datë 01.03.2021 me përbërje: A. K, K.V L. P.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,984,683 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) Teoren shpk me vlerë oferte 1,519,750 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 464,933 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.03.2021	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1. BOE óA...ô shpk dhe óN... ô shpk me vlerë oferte 1,488,000 lekë pa tvsh. 2. T... shpk me vlerë oferte 1,519,750

		lekë pa tvsh.
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ñnuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ñnuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata e shërbimit me nr.1090, datë 30.03.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe operatorit T... shpk me afat lëvrimi brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.	Zbatimi i kontratës: Është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim me shkresën nr.1090/1, datë 31.03.2021. Nga komisioni është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr.1090/4, datë 09.04.2021 për marrjen në dorëzim dhe montimin e tyre në Vilën nr.1 në Vlorë dhe Vilën në Dhërmi.	

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Nga Drejtoria e Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca është bërë kërkesa me nr.190, datë 20.01.2021 óKërkesë për impiant të Filtrimit të Ujitó. Me urdhrin nr.190/1, datë 25.01.2021 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e fondit limit me përbërje : B.T, D.T dhe E. L. Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit, me nr.190/2, datë 27.01.2021, ku llogaritja është bërë në bazë të tre ofertave të marra në treg dhe ka dalë në vlerën 1,984,683 lekë pa tvsh.

Është ngritur Urdhri me nr.190/3, datë 01.03.2021 për krijimin e njësisë së prokurimit me përbërje: P .K, B. H dhe A. D.

Është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.190/4, datë 01.03.2021 me fond limit 1,984,683 lekë pa tvsh, lloji i procedurës óKërkesë për Propozimó.

Është mbajtur procesverbali me nr.190/5, datë 01.03.2021 mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit.

Është ngritur Urdhri me nr.190/6, datë 01.03.2021 për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave me përbërje: A.K, K.V dhe L. P.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr.190/10, datë 12.03.2021, mbi hapjen e procedurës ku konstatohet se janë paraqitur dy operatorë ekonomik:

1. BOE óA...ó shpk dhe óN... ó shpk me vlerë oferte 1,488,000 lekë pa tvsh.

2. T... shpk me vlerë oferte 1,519,750 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali nr.2 me nr.190/11, datë 12.03.2021 mbi vlerësimin e ofertave ku konstatohet se operatorët kanë dorëzuar dokumentacionin në përputhje me dokumentet standarde të tenderit por një nga operatorët , BOE óA...ó shpk dhe óN... ó shpk me vlerë oferte 1,488,000 lekë pa tvsh, nuk ka paraqitur mostrat, kriter skualifikues në dokumentet standarde të tenderit.

-Nga auditimi u konstatua se procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, “PËR PROKURIMIN PUBLIK” :

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;

c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;

- ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
- d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
- dh) vlerën ose mënyrën e përlogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
- e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
- ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
- f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
- g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

Është mbajtur raporti përmbledhës me nr.190/13, datë 24.03.2021, ku është shpallur fitues operatori T.....shpk .

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata e shërbimit me nr.1090, datë 30.03.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe operatorit T.... shpk me afat lëvrimi brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim me shkresën nr.1090/1, datë 31.03.2021.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr.1090/4, datë 09.04.2021 për marrjen në dorëzim dhe montimin e tyre në Vilën nr.1 në Vlorë dhe Vilën në Dhërm.

2.) Procedura e Prokurimit : “Projekti i Hidroizolimit të tarracës së Pallatit të Kongreseve për vitin 2021”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Projekti i Hidroizolimit të tarracës së Pallatit të Kongreseve për vitin 2021”		
1. Urdhër Prokurimi nr.30, datë 08.02.2021 Njësinë e prokurimit : P. K D. K L.P	Projektimi bërë nga Auron Deliu, shef i sektorit të projekteve	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me urdhër nr.164, datë 08.02.2021 me përbërje: D.Xh K.V D.B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 805,382 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) A.....shpk me vlerë oferte 451,622 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 353,760 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 19.02.2021	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike A... shpk me vlerë oferte 451,622 lekë pa tvsh
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ñnuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ñnuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.94/15, datë 10.03.2021.	Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.322, datë 16.03.2021 është ngritur urdhri për marrjen në dorëzim të materialeve me përbërje: E. K E. Xh M. K Projekti është miratuar me vendimin nr.474, datë 28.07.2021, nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.	

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Nga auditimi u konstatua se procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, “PËR PROKURIMIN PUBLIK” :

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;

c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;

ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;

d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;

dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;

e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;

ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;

g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët , por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

3.) Procedura e Prokurimit : “Hidroizolimi i Tarracës së Pallatit të Kongreseve”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :Hidroizolimi i Tarracës së Pallatit të Kongreseve		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.240, datë 24.03.2021 Njësinë e prokurimit : D. K I.B L.P	2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me nr.368 datë 24.03.2021 me përbërje: A. Y; A.D; M. Q
5.Fondi Limit (pa tvsh) 25,024,452 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1.Operatori BOE óB....ô sh.p.k dhe óE...K....ô me vlerë oferte 24,653,040 lekë pa tvsh;	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 371,412 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.04.2021	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1.Operatori BOE óB...ô sh.p.k dhe óE...K....ô me vlerë oferte 24,653,040 lekë pa tvsh; 2.Operatori óK....ô sh.p.k me vlerë oferte 21,370,000 lekë pa tvsh; 3.Operatori óL.... K....ô me vlerë oferte 21,220,040 lekë pa tvsh; 4.Operatori óR... C....ô me vlerë oferte 23,958,980 lekë pa tvsh
11. Ankimime Nga operatori K....C.....me shkresën nr.1024/4, datë 26.03.2021 është paraqitur ankesa lidhur me dokumentet standarde të tenderit.	12. Përgjigje Ankesës Me urdhrin nr.375, datë 26.03.2021 është pezulluar procedura nga titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e procedurës. Është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës me urdhrin nr.382, datë 26.03.2021 me përbërje:	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ñ nuk ka

	E.... Xh...., K....B....dhe I.... G.... KSHA pasi ka marrë në shqyrtim ankesën kanë dalë në përfundim se pretendimet e operatorit nuk qëndrojnë.	
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr.1871/9, datë 24.08.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óB....ô sh.p.k dhe óE....K.....ô me vlerë 24,653,040 lekë pa tvshme afat 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës.		

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.240, datë 24.03.2021 me fond limit 25,024,452 lekë pa tvsh, lloji i procedurës óProcedurë e Hapurô dhe Njësi Prokurimi me përbërje: D. K, I. B dhe L.P.

Është mbajtur procesverbali me nr.1024/3, datë 24.03.2021, mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit nga Njësia e Prokurimit, ku nga auditimi konstatohet:

Nga auditimi konstatohet se disa nga kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit janë jo në përpjestim të drejtë me objektin e kontratës.

2.b. Operatori/et ekonomik duhet të kenë ne stafin e tij personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 5(pesë) punonjës të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë të punimeve në lartësi pajisur me kontratë pune, certifikatë trajnimi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Tetor 2020– Shkurt 2021.

- Lidhur me këtë pikë, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
 - i) certifikatat e punonjësve për punimet në lartësi.
 - ii) licencën e shoqërisë, e cila ka trajnuar punonjësit e Operatorit Ekonomik.
 - iii) listpagesat E-Sig të punonjësve të sipërcituar.
 - iv) Kontratë pune.

Kriter i pabazuar pasi hidroizolimi i tarracës nuk përbën punime në lartësi pasi tarraca është e mbyllur dhe e rrethuar , punimet në lartësi konsistojnë në fasada etj. dhe jo në një ambient të rrethuar .

e. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një Mjek, referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", të vërtetuar me kontratë pune, diplomë, Licencë të lëshuar sipas urdhrin të mjekut, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Tetor 2020 ñ Shkurt 2021.

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave óPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëô, pika 1, pika 3, germa óbô dhe pika 4 germa óbô thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, óPër masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punëô, **shfuqizohet**. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

Është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me urdhrin nr.368, datë 24.03.2021 me përbërje:

A.Y, A. D dhe M.Q.

Nga operatori K. Konstruksion me shkresën nr.1024/4, datë 26.03.2021 është paraqitur ankesa lidhur me dokumentet standarte të tenderit.

Me urdhrin nr.375, datë 26.03.2021 është pezulluar procedura nga titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e procedurës. Është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës me urdhrin nr.382,

datë 26.03.2021 me përbërje: E. Xh, K.B dhe I.G.

KSHA pasi ka marrë në shqyrtim ankesën kanë dalë në përfundim se pretendimet e operatorit nuk qëndrojnë. Pasi i është kthyer përgjigje operatorit është vijuar me heqjen e pezullimit të procedurës.

Nga APP gjithashtu është kërkuar ndryshimi i dokumenteve standarde të tenderit bazuar në problematikat e hasura në këtë procedurë prokurimi pasi APP ka vlerësuar se disa nga kriteret e përcaktuara nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik duke cenuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj furnizuesve.

Nga ana e autoritetit kontraktor janë pranuar dhe janë hartuar të gjitha ndryshimet lidhur me kriteret e përcaktuara në DST.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr.1024/20, datë 04.05.2021 mbi hapjen e procedurës ku konstatohet se janë paraqitur 4 operatorë ekonomik, përkatësisht:

Operatori BOE óB.ô sh.p.k dhe óE. K.....ô me vlerë oferte 24,653,040 lekë pa tvsh;

Operatori óK.....ô sh.p.k me vlerë oferte 21,370,000 lekë pa tvsh;

Operatori óL.....K.....ô me vlerë oferte 21,220,040 lekë pa tvsh;

Operatori óR.... C.....ô me vlerë oferte 23,958,980 lekë pa tvsh

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është miratuar raporti përmbledhës me nr.1871/3, datë 14.06.2021, ku janë skualifikuar operatorët: óK.....ô sh.p.k, óL.... K.....ô dhe óR... C.....ô dhe është shpallur fitues operatori me vlerë më të lartë: Operatori óB....ô sh.p.k me vlerë oferte 24,653,040 lekë pa tvsh.

Nga auditimi konstatohet se skualifikimi i operatorit óK.....ô sh.p.k me vlerë oferte 21,370,000 lekë pa tvsh është bërë me të drejtë pasi kishte shumë mangësi në dokumentacion.

Dy operatorët e tjerë me oferta ekonomike më të favorshme janë skualifikuar për kriteret si më poshtë:

1.Operatori ekonomik L... K.... nuk ka plotësuar kriterin 2.3.6 në të cilin kërkohet që:

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

Termoteknik 1 (një);

OE ka paraqitur dokumentacionin për një punonjës me profesion Termo Hidraulik.

Operatori ekonomik L... K.... nuk ka plotësuar kriterin 2.3.6 pika b, në të cilin kërkohet që:

b. Operatori/et ekonomik duhet të kenë ne stafin e tij personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 5(pesë) punonjës të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë të punimeve në lartësi pajisur me kontratë pune, certifikatë trajnimi, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Tetor 2020– Shkurt 2021.

• Lidhur me këtë pikë, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

v) certifikatat e punonjësve për punimet në lartësi.

vi) licencën e shoqërisë, e cila ka trajnuar punonjësit e Operatorit Ekonomik.

vii) listëpagesat E-Sig të punonjësve të sipërcituar .

viii) Kontratë pune.

OE nuk ka paraqitur asnjë punojë të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë të punimeve në lartësi që plotëson kriteret e kërkuara, pasi kompania e cila ka trajnuar këta punonjës nuk është e licencuar pra i mungon pika ii) licencën e shoqërisë, e cila ka trajnuar punonjësit e OE.

2. Operatori ekonomik L.... K.....nuk ka plotësuar kriterin 2.3.6 pika d në të cilin kërkohet që:

d. Operatori/ët ekonomik duhet të kenë ne stafin e tij personel të kualifikuar/ certifikuar si:

• 1 (një) inxhinier të certifikuar dhe trajnuar nga kompania prodhuese evropiane për përdorimin e materialeve hidroizoluese i pajisur me diplomë, kontratë pune, certifikatë trajnimi.

Nuk ka paraqitur asnjë inxhinier.

3.Operatori ekonomik óL.... K.....ô Sh.p.k nuk ka plotësuar kriterin 2.3. në të cilin kërkohet që:

2.3.8). Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Makineri shtrimi për materiale të lëngshme	Cope 1	Pronësi ose me qera
--	--------	---------------------

<i>hidroizoluese</i>		
----------------------	--	--

Nuk ka paraqitur asnjë mjet.

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë R...& N.... nuk ka plotësuar kriterin 2.3.6 në të cilin kërkohet që:

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

Termoteknik 1 (një)

B.O.E nuk ka paraqitur asnjë punonjës me profesion Termoteknik.

Ka paraqitur punonjës G.K. B i cili është me profesion Termo Hidraulik.

Operatori ekonomik të paraqesë për stafin e mësipërm kontratat pune, diplome dhe/ose kualifikimin përkatës për secilin punonjës. Dëshmia e kualifikimit dhe/ose diploma të jetë e lëshuar nga institucione të licencuara shtetërore Profesionale. Stafi i mësipërm të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për periudhën Tetor 2020 në Shkurt 2021.

Murator 1 (një)

B.O.E nuk ka paraqitur asnjë punonjës me profesion Murator. Dëshmia e kualifikimit dhe/ose diploma të jetë e lëshuar nga institucione të licencuara shtetërore Profesionale.

2. BOE R...& N..... nuk ka plotësuar kriterin 2.3.6 pika b, në të cilin kërkohet që:

b. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 5(pesë) punonjës të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë të punimeve në lartësi pajisur me kontratë pune, certifikatë trajnimi, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Tetor 2020– Shkurt 2021.

• Lidhur me këtë pikë, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ix) certifikatat e punonjësve për punimet në lartësi.
- x) licencën e shoqërisë, e cila ka trajnuar punonjësit e Operatorit Ekonomik.
- xi) listëpagesat E-Sig të punonjësve të sipërcituar.
- xii) Kontratë pune.

B.O.E nuk kanë paraqitur asnjë punonjës të trajnuar dhe të pajisur me certifikatë të punimeve në lartësi që plotëson kriteret e kërkuara, pasi , pasi kompania e cila ka trajnuar këta punonjës nuk është e licencuar pra mungon pika ii) licencën e shoqërisë, e cila ka trajnuar punonjësit e OE.

3. BOE R...& N.....nuk ka plotësuar kriterin 2.3.8 në të cilin kërkohet që:

2.3.8). Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

<i>Kamionçinë vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 1.5-2.5 ton</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
--	---------------	----------------------------

B.O.E kanë paraqitur vetëm një mjet me këtë kapacitet mbajtës me targe AB932BC, mjeti tjetër nuk ka kapacitetin mbajtës që kërkohet.

<i>Makineri shtrimi për materiale të lëngshme hidroizoluese</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
---	---------------	----------------------------

B.O.E kanë paraqitur një makineri për termoizolim dhe jo për hidroizolim.

Në përfundim është kualifikuar operatori Operatori BOE óB...ô sh.p.k dhe óE. K....ô me vlerë 24,653,040 lekë pa tvsh;

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr.1871/9, datë 24.08.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óB...ô sh.p.k dhe óE. K....ô me vlerë 24,653,040 lekë pa tvsh me afat 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

b. Zbatimi i kontratës “Hidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseve”.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 1871/9 prot., datë 24.08.2021 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Kontraktorit BOE óB...ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. N. B, me NIPTV dhe óE. K....ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. Ç. S, me NIPT K.....I, licencë në

zbatim NZ..... Vlera e kontratës është 24,653,040 lekë pa tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 15.09.2021 deri 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Për arsye se Pallati i Kongreseve është objekt i Trashëgimisë Kulturore, i vlerësuar si monument kulture i kategorisë së II, është e nevojshme të ketë një mbikëqyrje nga ana e specialistëve përkatës nga IKTK, përcaktimi i mbikëqyrësit nga Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe prej temperaturave mbi normat e lejuara data e fillimit të punimeve është shtyrë deri me datë 28.09.2021.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare me anë të letrës me nr.3668/4 prot. datë 29.10.2021, me lëndë Amendament shtyrje afati kontrate, ku konfirmon shtyrjen e afatit të punimeve referuar kërkesave me anë të shkresave respektive të Mbikëqyrësit të punimeve, Sipërmarrësit të punimeve dhe proces verbalit për pezullimit të punimeve për arsye të aktiviteteve në Pallatin e Kongreseve si dhe kushteve atmosferike. Data e rifillimit të punës do të jetë 23.11.2021 dhe data e përfundimit të punës do të jetë 21.12.2021. Ky amendament është firmosur nga Sipërmarrësi i punimeve i përfaqësuar nga Z. N.B dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor përfaqësuar nga Drejtuesi i Projektit znj. A.K.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr 2413/6 prot., datë 24.08.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Mbikëqyrësit N. M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 212,125 lekë pa tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 4859/2 prot., datë 13.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh... F dhe OE ó..... Constructiono përfaqësuar nga Z. G. S, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 32,700 lekë pa tvsh.

Miratimi i lejes

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore me anë të vendimit nr.474, datë 28.07.2021, miraton projektin óHidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseveó.

Projekti është hartuar nga A.....sh.p.k. me nr. Licencë nr.....

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbalit i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 28.09.2021. Punimet kanë përfunduar me datë 21.12.2021, sipas afatit të amenduar të kontratës.

Me anë te proces verbal konstatimi të volumeve që shtohen dhe zbriten i mbajtur me datë 16/11/2021 në prezencë të Investitorit të punimeve përfaqësuar nga Drejtuesi i Projektit znj. A.. K, Sipërmarrësi i punimeve BOE óB....ô sh.p.k. dhe óE. K....ô sh.p.k. përfaqësuar nga drejtuesi teknik ing. A. S dhe Mbikëqyrësi i punimeve ing. N. M, ku citohet që ó....meqenëse nga azhornimi fillestar i bërë gjatë zbatimit të projektit të objektit rezultuan ndryshime në disa zëra pune dhe në volume u vendos që ato do të paraqiten e përfshihen në tabelën përfundimtare të krahasimit të volumeve që do të bëhet me dije të Investitorit hap pas hapi me zhvillimin e punimeve, e do të jepet në mënyrë të saktë e përfundimtare para përfundimit të plotë të punimeve në objekt. Sipas azhornimit të gjendjes faktike të objektit krahasuar me preventivin e kontratës kemi konstatuar se është e domosdoshme që disa zëra të punimeve duhet të ndryshohen (shtohen ose zbriten).... ”.

Projekti është rishikuar dhe sasitë e rishikuara janë miratuar nga Drejtuesi i Projektit znj. A. K, Sipërmarrësi i punimeve BOE óB.ô sh.p.k. dhe óE. K...ô sh.p.k. përfaqësuar nga drejtuesi teknik ing. A. S dhe Mbikëqyrësi i punimeve ing. N. M, miratimet janë paraqitur me anë të proces verbaleve miratim ndryshimesh në volume dhe preventivit të ripunuar.

Pas rishikimit të volumeve, zbriten 1,048,192 lekë pa tvsh dhe shtohen 1,019,648 lekë pa tvsh. Vlera e preventivit të ripunuar është 24,624,496 lekë pa tvsh. Vlera e kontratës fillestare zbritet me 28,544 lekë pa tvsh.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të zbatimit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe verifikimit në terren u konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si mëposhtë:

1. Zëri I.2 me nr.anal.2.426/3 Prishje shtrese betoni dhe zëri I.4 me nr.anal.3.158/5a Transport dheu me auto deri 10 km përfshijnë të njëjtat sasi punimesh.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Projekt preventivi,
- 2) Libri i masave,
- 3) Situacioni përfundimtar,
- 4) Korrespondenca,
- 5) Ditarët e objektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Hidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseve”				
14.Lidhja e kontratës nr. 1871/9 prot., datë 24.08.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 24,653,040 lekë pa tvsh / 29,583,648 lekë me tvsh BOE fitues “B..” sh.p.k. dhe “E. K...” sh.p.k.		16.Likuiduar deri dt 21.12.2021 me vlerë 29,549,395 lekë me t.v.sh.	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 29,549,395 lekë me tvsh	18.Afati i kontratës në dite (60 ditë) Fillimi punimeve: 28.09.2021 Përfundimi punimeve: 21.12.2021		19. Zgjatja e kontratës Amendim kontrate nr.3668/4 prot. datë 29.10.2021 për arsye pezullimi afati kohor i zbatimit në ditë pune nuk ndryshon, data e përfundimit të punimeve shtyhet me 21.12.2021.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N.M	Licenca Nr.:	Kontrata me nr.2413/6 prot., datë 24.08.2021		
21. Kolaudatori i punimeve óG.... C.....ô sh.p.k.	Licenca Nr.....	Kontrata me nr.4859/2 prot., datë 13.12.2021		
22.Akt Kolaudimi datë 24/12/2021	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 28/12/2021			

Nga auditimi i librezave të masave, situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I.4	Transport dheu me auto deri 10.0 km	m3	450	379.65	379.65	0	379.65	170,846
	Total							170,846

Zëri I.4 Transport dheu me auto deri 10.0 km. Referuar zërave të manualit të çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015, për punimet e prishjes përkatësisht anal. Nr. 2.426/3 Prishje shtresa

betoni kanë të përfshirë në çmim sigurime shoqërore dhe transportin. Sipas faktit, ky zë pune përfshin transportin e materialeve nga prishja e shtresës së betonit.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp pl 8%	Fitim 10%	TOTALI
Kodi			op	çmimi	Vlefte	T*km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3																
	Sp + p	op	18.8	125	2350													
	Sigurime shoqërore 16.7%	leke	2350	0.167	392													
	Transport	T*km				11	21	231										
	Shuma:				2742			231							2973	238	297	3509

Nga verifikimi i situacionit përfundimtar dhe librezat e masave si dhe analizat e çmimeve bashkëlidhur projekt preventiv të tenderuar, rezulton se sasia prej 379.65 m3 është marrë në zërin e Prishje shtresa betoni, për rrjedhojë transporti është i llogaritur brenda çmimit të këtij zëri. Vlera e këtij volumi punepër zërin *Transport dheu me auto deri 10.0 km* prej 379.65 m3 është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 170,846 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** N.M nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*”, i ndryshuar, neni 7/1 ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

3) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 2413/6 prot., datë 24.08.2021.

Në lidhje me Akt konstatimin nr. 5 datë 10.06.2022:

Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pajustificuar ó <i>Hidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseveô</i>
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: ó<i>Hidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseveô</i>, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk justifikohen bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Këto diferenca rezultuan në zërat si mëposhtë: ○ Zëri ó<i>Transport dheu me auto deri 10.0 kmô</i>. Vlera prej 170,846 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Argumentimi i kësaj difference pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.5 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Kriteri:	Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 óPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 óPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> Pika 8.1 <i>Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.</i> Pika 8.3 <i>Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i> - Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 óPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, neni 7/1 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i> - VKM nr.629 datë 15.07.2015 óPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre, i ndryshuar. - Kontratës publike shërbime me nr. 1871/9 prot. datë 24.08.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik óB...ô sh.p.k. dhe óE.. K.....ô sh.p.k. Vlera e kontratës është 24,653,040 lekë pa tvsh. Afati zbatimit të kontratës fillon nga data 15.09.2021 deri 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. - Amendament shtyrje afati kontrate me nr.3668/4 prot. datë 29.10.2021, ku konfirmon shtyrjen e afatit të punimeve, data e rifillimit të punës do të jetë 23.11.2021 dhe data e përfundimit të punës do të jetë 21.12.2021. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 2413/6 prot, datë 24.08.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Mbikëqyrësit ing. N.M, me vlerë të kontratës së shërbimit 212,125 lekë pa tvsh. - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.4859/2 prot., datë 13.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe OE óG.... C.....ô, me vlerë të kontratës së shërbimit 32,700 lekë pa tvsh. - Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.474 datë 28.07.2021, miratuar nga KKTK.
------------------------	--

	- Librezat e masave, situacioni përfundimtar, vizatimet As Built etj.
Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, shpenzim i pajustificuar dhe i përfituar pa të drejtë shuma 170,846 lekë pa tvsh.
Shkaku	Mungesë e kontrollit të përshkrimit të zërave të preventivit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Nga DSHQ të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 170,846 lekë pa tvsh nga BOE óB...ô sh.p.k. dhe óE...K.....ô sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 1871/9 prot. datë 24.08.2021, me objekt óHidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseveô, vlerë kjo që përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve ing. N. M, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 2413/6 prot, datë 24.08.2021 dhe znj A. Kme detyrë Drejtuese Projekti.

4.) Procedura e Prokurimit : “Rikonstruksion i tre zyrave të ish Presidentëve”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion i tre zyrave të ish Presidentëve		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.218, datë 18.03.2021	3. Urdhër për krijimin e njësisë së prokurimit me nr.340, datë 18.03.2021 me përbërje D.B P.K L.P	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me nr.341 datë 18.03.2021 me përbërje: A. Y A. D K. V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 12,272,500 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) .Operatori BOE óB.. M...ô dhe óT....ô shpk, me vlerë oferte 12,009,310 lekë pa tvsh;	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 263,190 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.04.2021	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike 1.Operatori óE...V.ô pa dokumentacion; 2.Operatori óSh.....ô pa dokumentacion; 3.Operatori BOE óB.. M...ô dhe óT....ô shpk, me vlerë oferte 12,009,310 lekë pa tvsh;
11. Ankimime	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KKP në nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr.959/22 datë 20.05.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óB.. M...ô dhe óT....ô shpk, me vlerë oferte 12,009,310 lekë pa tvsh me afat 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës.	Zbatimi i kontratës:	

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.218, datë 18.03.2021 me fond limit 12,272,500 lekë pa tvsh , lloji i procedurës óProcedurë e Hapuró dhe Njësi Prokurimi me përbërje: D. K, P. K dhe L. P. Është mbajtur procesverbali me nr.959/3, datë 18.03.2021, mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit nga Njësia e Prokurimit.

Është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me urdhrin nr.341, datë 18.03.2021 me përbërje: A. Y, A. D dhe K. V.

Nga operatori Sh.....shpk me shkresën nr.959/6, datë 24.03.2021 është paraqitur ankesa lidhur me dokumentet standarde të tenderit.

Me urdhrin nr.959/7, datë 24.03.2021 është pezulluar procedura nga titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e procedurës. Është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës me urdhrin nr.364, datë 24.03.2021 me përbërje: E.K, K. B dhe E. L.

KSHA pasi ka marrë në shqyrtim ankesën kanë dalë në përfundim se pretendimet e operatorit nuk qëndrojnë. Pasi i është kthyer përgjigje operatorit është vijuar me heqjen e pezullimit të procedurës. Nga APP gjithashtu është kërkuar ndryshimi i dokumenteve standarde të tenderit bazuar në problematikat e hasura në këtë procedurë prokurimi pasi APP ka vlerësuar se disa nga kriteret e përcaktuara nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik duke cenuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj furnizuesve.

Nga ana e autoritetit kontraktor janë pranuar dhe janë hartuar të gjitha ndryshimet lidhur me kriteret e përcaktuara në DST.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr.959/15, datë 23.04.2021 mbi hapjen e procedurës ku konstatohet se janë paraqitur 3 operatorë ekonomik, përkatësisht:

Operatori óE. V...ô pa dokumentacion;

Operatori óSh....ô pa dokumentacion;

Operatori BOE óB.. M...ô dhe óT....ô shpk, me vlerë oferte 12,009,310 lekë pa tvsh;

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është miratuar raporti përmbledhës me nr.959/17, datë 06.05.2021, ku është shpallur fitues operator BOE óB.. M...ô dhe óT....ô shpk, dhe janë skualifikuar operatorët e tjerë për mosparaqitje të dokumentacionit.

-Nga auditimi u konstatua se procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, “PËR PROKURIMIN PUBLIK” :

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;

c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;

ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;

d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;

dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;

e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;

ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;

g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr.959/22 datë 20.05.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óB.. M...ô dhe óT....ô shpk, me vlerë oferte 12,009,310 lekë pa tvsh me afat 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

b. Zbatimi i kontratës “Rikonstruksioni i tre zyrave të ish presidentëve”.

Në lidhje me Akt Verifikimin nr. 1 datë 11.05.2022, nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: óRikonstruksioni i tre zyrave të ish presidentëveô, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Mbikëqyrësit të punimeve u konstatua që punimet e kryera janë realizuar konform Projektit dhe preventivit të rishikuar.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 959/22 prot., datë 20.05.2021 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.Fdhe Kontraktorit BOE óM...ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. E.B., me NIPT L....C dhe óT....ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. J.T., me NIPT K.....G. Vlera e kontratës është 12,009,310 lekë pa tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 27.05.2021 deri në 2 muaj (60ditë) nga nënshkrimi i kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr 1704/5 prot., datë 27.05.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Mbikëqyrësit óA.....ô sh.p.k. përfaqësuar nga inxh. E. M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2892/5, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 110,554.1 lekë pa tvsh. Afati i zbatimit të kësaj kontrate do të jetë duke filluar nga data e sotme deri 2 muaj (60 ditë) nga nënshkrimi i kontratës.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.2864/2 prot., datë 22.07.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.Fdhe OE óG... C....ô përfaqësuar nga Z. L.H, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 10,500 lekë pa tvsh. Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 22.07.2021.

Projekti

Projekti është hartuar nga A..... sh.p.k.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit, proces verbali i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 27.05.2021. Sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve dhe proces verbalit të përfundimit të punimeve, punimet kanë përfunduar me datë 26.07.2021, sipas afatit të kontratës.

Për rishikimit e projektit është mbajtur dokumentacioni përkatës dhe janë bërë miratimet e tij nga të gjitha palët. Dokumentacioni i mbajtur janë si mëposhtëm:

- Proces Verbal konstatimi të punimeve që shtohen e hiqen në preventivin fillestar i mbajtur me datë 9/06/2021.
- Shkresa e mbikëqyrësit me lëndë kërkesë për miratim përfundimtar nga Autoriteti Kontraktor të procedurës së óNdryshimeve në volumeô të objektit óRikonstruksioni i tre zyrave të ish Presidentëveô drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, me datë 16.06.2021.
- Si dhe proces verbali mbi miratimin përfundimtar të ndryshimeve në volume si edhe miratim të punimeve që shtohen dhe të punimeve që zbriten në preventivin fillestar të

punimeve, miratim të preventivit të ripunuar dhe të ndryshimeve në projekt preventiv, i mbajtur me datë 16/06/2021.

- Tabela +- e miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Drejtuesi i Projektit z. L. T., Sipërmarrësi i punimeve BOE óM....ô sh.p.k. dhe óT.....ô sh.p.k. përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Z. E.B. dhe Mbikëqyrësi i punimeve óA.....ô sh.p.k. ing. E. M. Zbriten 285,567.50 lekë pa tvsh dhe shtohen 261,572.95 lekë pa tvsh, vlera e kontratës zbritet me 23,994.55 lekë pa tvsh.
- Preventivi i ripunuar i miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Drejtuesi i Projektit z. L. T., Sipërmarrësi i punimeve BOE óM....ô sh.p.k. dhe óT.....ô sh.p.k. përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Z. E.B. dhe Mbikëqyrësi i punimeve óA.....ô sh.p.k. ing. E. M. Vlera e preventivit të ripunuar është 11,985,315 lekë pa tvsh.

Librezat e masave janë miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve dhe situacioni përfundimtar është miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Drejtuesha znj. Dh.F dhe Drejtuesi i Projektit z. L. T., Sipërmarrësi i punimeve BOE óM....ô sh.p.k. dhe óT.....ô sh.p.k. përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Z. E. B dhe z.J.T dhe Mbikëqyrësi i punimeve óA.....ô sh.p.k. ing. N. M. Vlera e punimeve të certifikuara është 11,985,315 lekë pa tvsh, (mbajtur garanci punimesh vlera 719,118.90 lekë me tvsh).

Akt kolaudimi për objektin: Rikonstruksioni i tre zyrave të ish presidentëve, datë 30/07/2021. Kolaudimi i punimeve u bë nga 22.07.2021 deri 30.07.2021, dhe është mbajtur në prezencë të Mbikëqyrësit të punimeve A..... sh.p.k., përfaqësuar nga ing. N. M, Sipërmarrësi i punimeve i përfaqësuar nga drejtuesi ligjor z. E. B dhe drejtuesi teknik ing. K. C dhe kolaudatori i punimeve ing. L.H.

Proces Verbal i marrjes në dorëzim të punimeve për objektin: Rikonstruksioni i tre zyrave të ish presidentëve, datë 23/08/2021 nr.2918/4 prot., ku komisioni i ngritur me Urdhër nr.1206 prot. datë 16.08.2021, i përbërë nga znj. A.K, z. E. K dhe z. E.I, me anë të këtij proces verbali të marrjes në dorëzim, pranon dhe merr në dorëzim objektin Rikonstruksioni i tre zyrave të ish presidentëve.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i tre zyrave të ish presidentëve”				
14.Lidhja e kontratës nr. 959/22 prot., datë 20.05.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 12,009,310 lekë pa tvsh / 14,411,172 lekë me tvsh BOE fitues “M....” sh.p.k. dhe “T.....” sh.p.k.		16.Likuiduar deri datë 23.08.2021 me vlerë 13,663,259 lekë me t.v.sh.	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 14,382,378 lekë me t.v.sh.	18.Afati i kontratës në ditë (60 ditë) Fillimi punimeve: 27.05.2021 Përfundimi punimeve: 26.07.2021		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve óA.....ô sh.p.k	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 1704/5 prot., datë 27.05.2021		
21. Kolaudatori i punimeve óG... C....ô	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 2864/2 prot., datë 22.07.2021		
22.Akt Kolaudimi datë 30/07/2021	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 23/08/2021			

5.) Procedura e Prokurimit : “Materiale pajisje Elektroshtëpiake për vitin 2021”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Materiale pajisje Elektroshtëpiake për vitin 2021		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.25, datë 22.01.2021	2.Fondi limit Me urdhrin nr.10, datë 07.01.2021 është ngritur grupi i punës për	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, Me Urdhrin nr.82, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	llogaritjen e fondit limit me përbërje : E.K, D. Tdhe I. G.	me përbërje : S.M, K. B dhe L. P.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,733,656 lekë pa tvsh lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) Operatori óT...ô shpk, me vlerë oferte 1,433,848 pa tvsh;	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 299,808 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit 05.02.2021	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike Operatori óA.K.M A....I.... Groupôshpk me vlerë oferte 1,654,280 lekë pa tvsh. Operatori óB....ô shpk me vlerë oferte 1,406,000 lekë pa tvsh Operatori óT...ô shpk, me vlerë oferte 1,433,848 pa tvsh;
11. Ankimime	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KKP ñ nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.562/3 datë 23.02.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Operatori óT...ô shpk, me vlerë 1,433,848 pa tvsh me afat 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	Zbatimi i kontratës: Është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr.562/5, datë 25.02.2021.	

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me shkresën nr.21, datë 05.01.2021, óKërkesë/Pajisje Elektroshtëpiakeô janë hartuar kërkesat për pajisje elektroshtëpiake për rezidencat por konstatohet se nuk ka një plan shpërndarje sipas nevojave nëpër qendra rezidenciale.

Me urdhrin nr.10, datë 07.01.2021 është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit me përbërje : E. K, D. T dhe I.G.

Është mbajtur procesverbali me nr.21/2, datë 21.01.2021 për llogaritjen e fondit limit ku vlera e fondit limit ka dalë në vlerën 1,733,656 lekë pa tvsh në bazë të tre ofertave të marra në treg.

Është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.25, datë 22.01.2021, Procedura e Prokurimit óKërkesë për Propozimô, Fondi limit në vlerën 1,733,656 lekë pa tvsh dhe njësi prokurimi: P. K, D.Kdhe A.D.

Me shkresën nr.21/5, datë 22.01.2021 është mbajtur procesverbali mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit.

Me Urdhrin nr.82, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave me përbërje : S.M, K. B dhe L. P.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr.21/9, datë 05.02.2021 mbi hapjen e procedurës ku konstatohet se janë paraqitur 3 operatorë ekonomik, përkatësisht:

1. Operatori óA.K.M A.... I.... G....ôshpk me vlerë oferte 1,654,280 lekë pa tvsh.
2. Operatori óB...ô shpk me vlerë oferte 1,406,000 lekë pa tvsh.
3. Operatori óT...ô shpk, me vlerë oferte 1,433,848 pa tvsh.

-Nga auditimi u konstatua se procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit12 të ligjit Nr. 9643, “PËR PROKURIMIN PUBLIK” :

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të

ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

- a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
- b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
- c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
- ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
- d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
- dh) vlerën ose mënyrën e përlllogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
- e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
- ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
- f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
- g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është miratuar raporti përmbledhës me nr.21/11, datë 17.02.2021, ku është shpallur fitues Operatori óT...ô shpk, me vlerë oferte 1,433,848 pa tvsh si operatori me çmimin më të ulët pasi operatori B....u tërhoq nga procedura e prokurimit

-Lidhja e kontratës

Është lidhur kontrata me nr.562/3 datë 23.02.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Operatori óT...ô shpk, me vlerë 1,433,848 pa tvsh me afat 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr.562/5, datë 25.02.2021.

6.) Procedura e Prokurimit : “Shërbim Servisi dhe pjesë këmbimi për automjetet e DSHQ”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Materiale pajisje Elektroshtëpiake për vitin 2021		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr.714, datë 29.09.2020	3. Urdhër për krijimin e njësisë së prokurimit me nr.179, datë 29.09.2020 me përbërje P. K B.H E. K	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me nr.180, datë 29.09.2020 me përbërje: S.M, K.B L. P.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,672,971 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) T... A... dhe óC.....ô shpk me vlerë oferte 5,668,301 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,670 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit 16.10.2020	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike Operatori óA....ôsha Operatori óT.....A....ô shpk dhe óC.....ô shpk
11. Ankimime Është paraqitur ankesa nga operatori óAuto M....servisô sh.p.k, i cili është hartur mbi kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor	12. Përgjigje Ankesës Pasi është pezulluar procedura me Urdhrin nr.193, datë 05.10.2020, është ngritur dhe komisioni i shqyrtimit të ankesës me përbërje: L.T., D. B. dhe I.G.. Komisioni i shqyrtimit të ankesë ka vendosur të pranojë ankesën për disa prej pika	13. Përgjigje Ankesës nga KKP në Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.584/2020, datë 18.12.2020 ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit A... dhe nga autoriteti kontraktor të vijohet me hapat e mëtejshëm të procedurës.

	dhe ka vendosur të bëjë ndryshimet në dokumentet standarde të tenderit .	
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr.4656, datë 30.12.2020 óMarrëveshje kuadërô midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óT.....A.....ô shpk dhe óC.....ô shpk me afat 12 muaj dhe me vlerë 5,668,301 lekë pa tvsh.	Zbatimi i kontratës:	

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Me urdhrin nr.179, datë 29.09.2020 është ngritur Njësia e Prokurimit me përbërje: P. K, B.H. dhe E. K.

Është ngritur Urdhri i Prokurimit me nr.714, datë 29.09.2020, Procedura e Prokurimit óKërkesë për Propozimô (Marrëveshje kuadër), Fondi limit në vlerën 5,672,971 lekë.

Me shkresën nr.3310/2, datë 29.09.2021 është mbajtur procesverbali mbi hartimin e dokumenteve standarde të tenderit.

Me Urdhrin nr.180, datë 29.09.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave me përbërje : S.M, K. Bdhe L. P.

Pranë autoritetit Kontraktor është paraqitur ankesa nga operatori óAuto M.....ô sh.p.k, i cili është hartur mbi kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor.

Pasi është pezulluar procedura me Urdhrin nr.193, datë 05.10.2020, është ngritur dhe komisioni i shqyrtimit të ankesës me përbërje: L. T., D. B. dhe I. G. Komisioni i shqyrtimit të ankesë ka vendosur të pranojë ankesën për disa prej pika dhe ka vendosur të bëjë ndryshimet në dokumentet standarde të tenderit .

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe për zgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Është mbajtur procesverbali nr.1 me nr.3310/13, datë 16.10.2020 mbi hapjen e procedurës ku konstatohet se janë paraqitur 2 operatorë ekonomik, përkatësisht:

1. Operatori óA....ôsha
2. Operatori óT.....A.....ô shpk dhe óC.....ô shpk

Por është konstatuar se operatori A.... ka ardhur me vlerë anomalisht të ulët, në vlerën 2,488,700 lekë pa tvsh, dhe i është lënë kohë për të dhënë sqarimet mbi ofertën anomalisht t ulët.

-Nga auditimi u konstatua se procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, "PËR PROKURIMIN PUBLIK" :

2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

- a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
- b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
- c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korrigjimeve të bëra në këto dokumente;
- ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
- d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
- dh) vlerën ose mënyrën e përlogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore

për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;

e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;

ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;

g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

Pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

Operatori A. me shkresën nr. 3310/10, datë 30.10.2020 ka dorëzuar formularin e ankesës lidhur me dorëzimin në sistem të dy ofertave ekonomike dhe ofertën anomalisht të ulët.

Procedura është pezulluar dhe pasi është shqyrtuar ankesa është vendosur që të mos pranohej. Më pas Shoqëria A.... është ankuar pranë Komisionit të Prokurimit publik me shkresën nr.3310/16, datë 11.11.2020.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.584/2020, datë 18.12.2020 ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit A..... dhe nga autoriteti kontraktor të vijohet me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Është shpallur fitues operatori ekonomik T... A... dhe óC.....ô shpk me vlerë oferte 5,668,301 lekë pa tvsh.

Është lidhur kontrata me nr.4656, datë 30.12.2020 óMarrëveshje kuadërô midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óT.....A.....ô shpk dhe óC.....ô shpkme afat 12 muaj dhe me vlerë 5,668,301 lekë pa tvsh.

Titulli i Gjetjes:	Mbi Prokurimet publike
Situata:	1-Nga auditimi konstatua se në DSHQ dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit. 2-Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit12 të ligjit Nr. 9643, óPËR PROKURIMIN PUBLIKô pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.
Kriteri:	-Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 óPër arkivatô -VKM.nr.914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô, neni 12.
Ndikimi/efekti:	-Evidentimin, sistemimi dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi. -Vendosja e vlerave të ofertave të ardhura nga operatorët ndikon në transparencën e procesit të prokurimit.
Shkaku:	-Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike. -Mos vendosja e vlerave të ofertave të ardhura nga operatorët në procesverbalin e hapjes dhe vlerësimit të procedurës.
Rëndësia e shkeljes:	E mesme

Rekomandimi	1- Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor. 2-Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të merren masa për të gjitha rastet e procedurave të prokurimit në vijim, hartimi i procesverbalit nr.2 të hapjes dhe vlerësimit të ofertave të kryhet në përputhje me bazën ligjore në mënyrë respektimin e transparencës në këto procedura.
--------------------	---

7.Zbatimi i kontratës “Suvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve”.

Kontratata

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 617/20 prot., datë 06.05.2021 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Kontraktorit BOE óT.....ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. J. T, me NIPT K.....G dhe óSh.....ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. Y.B, me NIPT K.....N, liçencë në zbatim NZ..... Vlera e kontratës është 9,264,800 lekë pa tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 24.05.2021 deri në 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Sipas shkresës nr.2005/4 prot. datë 07.07.2021, ku theksohet se duke qenë se Pallati i Kongreseve është objekt i Trashëgimisë Kulturore, i vlerësuar si monument kulture i kategorisë së II, është e nevojshme të ketë një mbikëqyrje nga ana e specialistëve përkatës nga IKTK. Si rrjedhojë e komunikimit ndër-institucional si dhe afatet ligjore që duhen respektuar gjatë komunikimeve zyrtare, fillimi i punimeve është shtyrë dhe është dakortuar që në datën e fillimit të punimeve të lidhet një aneks kontratë midis palëve.

Aneks Kontrata nr.1 me nr.617/24 prot. datë 21.07.2021, e kontratës së sipërmarrjes nr. Prot. 617/20 datë 06.05.2021, midis AK dhe BOE óT.....ô sh.p.k. dhe óSh.....ô sh.p.k., ku neni 4 i kontratës së sipërmarrjes ndryshohet si mëposhtë:

4.1 Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 21.07.2021 deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës, bazuar në relacionin e mbajtur nga Drejtuesi i Projektit me nr. .617/23 datë 24.05.2021.

AK me anë të letrës me nr.3422/2 prot. datë 25.11.2021, me lëndë Amendament shtyrje afati kontrate, konfirmon shtyrjen e afatit të punimeve referuar kërkesave me anë të shkresave respektive bashkëlidhur të Mbikëqyrësit të punimeve, Sipërmarrësit të punimeve dhe proces verbalit për pezullimit të punimeve. Data e rifillimit të punës do të jetë 25.11.2021 dhe data e përfundimit të punës do të jetë 09.12.2021. Ky amendament është miratuar nga Sipërmarrësi i punimeve i përfaqësuar nga Z. J.T dhe përfaqësuesi i AK Drejtuesi i Projektit znj. A.K.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr 1157/5 prot., datë 06.05.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Mbikëqyrësit N. M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 116,300 lekë pa tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 4860/2 prot., datë 13.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe OE óG... C.....ô përfaqësuar nga Z. G.S, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 12,400 lekë pa tvsh.

Miratimi i lejes

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore me anë të vendimit nr.8, datë 30.04.2021, miraton projektin óSuvatimit me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseveô.

Projekti është hartuar nga A..... sh.p.k. me nr. Licencë nr.....

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 21.07.2021. Punimet kanë përfunduar me datë 09.12.2021, sipas afatit të amenduar të kontratës.

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare, me anë të letrës me nr.617/27 prot. datë 20.08.2021 me lëndë: Pezullim punimesh për procedurën me objekt óSuvatimi me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve, drejtuar Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve për dijeni IKTk, kërkon ndërprerje e punimeve për shkak të eventeve të parashikuara për tu zhvilluar në Pallatin e Kongreseve gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu për shkak të temperaturave të larta nuk këshillohet të kryhet aplikimi i suvasë plastike. Për rifillimin e punimeve do ketë një njoftim të dytë nga AK.

Për pezullimin e punimeve janë mbajtur Proces Verbal pezullim punimesh të miratuar nga AK, Sipërmarrësi i punimeve dhe Mbikëqyrësi i punimeve, gjithashtu janë njoftimet përkatëse të Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit për pezullim punimesh.

Autoritetit Kontraktor ka njoftuar Mbikëqyrësin e punimeve dhe Sipërmarrësin të punimeve, për dijeni IKTk me nr.3422/2 prot., datë 25.11.2021, ku thuhet se punimet rifillojnë me datë 25.11.2021.

Librezat e masave janë miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve, mungojnë vizatimet e zbatimit të librezave të masave dhe situacioni përfundimtar është miratuar nga AK përfaqësuar nga Drejtoresha znj. Dh.F dhe Drejtuesi i Projektit znj. A.K, Sipërmarrësi i punimeve BOE óT..... sh.p.k. dhe óSh..... sh.p.k. përfaqësuar nga Z. J.T dhe Mbikëqyrësi i punimeve ing. N. M.

Vlera e punimeve të certifikuara është 11,117,760 lekë me tvsh, protokolluar në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare me nr.3422/7 prot. datë 09.12.2021.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të zbatimit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe verifikimit në terren u konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si mëposhtë:

1. Zëri I.1 me nr.anal.AN Prishje suvatim i jashtëm dhe zëri I.2 me nr.anal.2.37/3b Transport materiale ndërtimi me auto deri në 8.0 km përfshijnë të njëjtat sasi punimesh.
2. Suvatimi i parapeteve të shkallës aksi H-I nga veriu dhe nga jugu ka gjatësi 10m dhe është realizuar vetëm në dy anët e jashtme.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Projekt preventivi,
- 2) Libri i masave,
- 3) Situacioni përfundimtar,
- 4) Korrespondenca,
- 5) Ditarët e objektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Suvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve”		
14.Lidhja e kontratës nr. 617/20 prot., datë 06.05.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 9,264,800 lekë pa tvsh / 11,117,760 lekë me tvsh BOE fitues “T.....” sh.p.k. dhe “Sh.....” sh.p.k.	16.Likuiduar deri datë 09.12.2021 me vlerë 11,117,760 lekë me t.v.sh.
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 11,117,760 lekë me tvsh	18.Afati i kontratës në ditë (45 ditë) Fillimi punimeve: 21.07.2021 Përfundimi punimeve: 09.12.2021	19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr.617/24 prot. datë 21.07.2021 shtyhet data e fillimit të punimeve.

			Amendim kontrate nr. 3422/2 prot. datë 25.11.2021 për arsye pezullimi afati kohor i zbatimit në ditë pune nuk ndryshon, data e përfundimit të punimeve shtyhet me 09.12.2021.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N. M	Licenca Nr: MK	Kontrata me nr. 1157/5 prot., datë 06.05.2021		
21. Kolaudatori i punimeve óG... C.....ô sh.p.k.	Licenca Nr: MK	Kontrata me nr. 4860/2 prot., datë 13.12.2021		
22.Akt Kolaudimi datë 14/12/2021	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 15/12/2021			


Nga auditimi i librezave të masave, situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr.	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I.2	<i>Transport materiale ndërtimi me auto deri në 8.0 km</i>	m3	400	30	33.18	0	30	12,000
II.1	<i>Kollë speciale antilagështirë me fibra</i>	m2	400	2,432.6	2,437.3	2,353.3	79.3	31,720
II.2	<i>Suva plastike e kompletuar me pigment</i>	m2	2,600	2,432.6	2,437.3	2,353.3	79.3	206,180
	Total							<u>249,900</u>

Zëri I.2 Transport materiale ndërtimi me auto deri në 8.0 km. Referuar zërave të manualit të çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015, dhe analizave të çmimeve të projekt preventivit për punimet e prishjes përkatësisht anal. Nr. AN Prishje suvatim i jashtëm kanë të përfshirë në çmim sigurime shoqërore dhe transportin. Sipas faktit, ky zë pune përfshin transportin e materialeve nga prishjes së suvatimit të jashtëm.

ANALIZA TEKNIKE CMIMI																		
Nr. Kodi	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp pl 8%	Fitim 10%	TOTALI
			op	çmimi	Vlefte	T*km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
AN	Suva plastike e kompletuar me pigment	m2																
	Sp + p	op	2.2	186	409													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	409.2	0.167	68													
	Transport	T*km				0.50	21	11										
	Vinç kulle	op							0.13	210	27.3							
	Suva plastike importi me pigment	kg										2.2	810	1782				
	Shuma :				478			11			27.3			1782	2297	184	230	2711
AN	Kolle speciale anti lageshtire me fibra	m2																
	Sp + p	op	1.1	186	205													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	204.8	0.167	34													
	Transport	T*km				0.50	21	11										
	Vinç kulle	op							0.13	210	27.3							
	Kolle speciale anti lageshtire me fibra	kg										2.8	31	87				
	Shuma :				239			11			27.3			87	363	29	36	429
AN	Prishje suvatim i jashtem	m3																
	Sp + p	op	1.2	125	150													
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	150	0.167	25													
	Transport	T*km				10	21	210							385	31	39	454
	Shuma:				175			210										



Nga verifikimi i situacionit përfundimtar dhe librezat e masave si dhe analizat e çmimeve bashkëlidhur projekt preventivit të tenderuar, rezulton se sasia prej 30 m3 është marrë në zërin e Prishje shtresa betoni, për rrjedhojë transporti është i llogaritur brenda çmimit të këtij zëri. Vlera e këtij volumi punepër zërin *Transport materiale ndërtimi me auto deri në 8.0 km* prej 30 m3 është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri II.1 Kollë speciale antilageshtirë me fibra. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 2,432.6 m2 dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 2,437.3. Pas verifikimit në terren u konstatua që suvatimi i parapeteve të shkallës aksi H-I nga veriu dhe nga jugu është realizuar me gjatësi 10m dhe vetëm në dy anët e jashtme të parapetëve. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 2,353.3 m2, ose 79.3 m2 më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri II.2 Suva plastike e kompletuar me pigment. Sipas situacionit përfundimtar sasia e këtij zëri pune është 2,432.6 m2 dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 2,437.3. Pas verifikimit në terren u konstatua që suvatimi i parapeteve të shkallës aksi H-I nga veriu dhe nga jugu është realizuar me gjatësi 10m dhe vetëm në dy anët e jashtme të parapetëve. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 2,353.3 m2, ose 79.3 m2 më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 249,900 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** N.M nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

- 2) Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”*, i ndryshuar, neni 7/1 ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

3) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 1157/5 prot., datë 06.05.2021.

Në lidhje Akt konstatimin nr. 6 datë 10.06.2022:.

Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pajustificuar <i>“Suvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve”</i>
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: <i>óSuvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseveó</i>, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk argumentohet apo justifikohet. Gjithashtu mungojnë dhe vizatimet e librezave të masave. Këto diferenca rezultuan në zërat si mëposhtë: ○ Zëri óTransport materiale ndërtimi me auto deri në 8.0 kmó. Vlera prej 12,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri óKollë speciale antilagështirë me fibraó. Vlera prej 31,720 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri óSuva plastike e kompletuar me pigmentó. Vlera prej 206,180 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Argumentimi i kësaj difference pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.6 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.
Kriteri:	Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 óPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitó, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 óPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimitó, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <i>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi të, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.</i> <i>Pika 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i> - Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 óPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitó, i ndryshuar, neni 7/1 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të</i>

	<i>projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i> - VKM nr.629 datë 15.07.2015 óPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre, i ndryshuar. - Kontratës publike shërbime me nr. 617/20 prot. datë 06.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik óT.....ó sh.p.k. dhe óSh.....ó sh.p.k. Vlera e kontratës është 9,264,800 lekë pa tvsh. Afati zbatimit të kontratës fillon nga data 24.05.2021 deri në 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. - Aneks Kontrata nr.1 me nr.617/24 prot. datë 21.07.2021, e kontratës së sipërmarrjes nr. Prot. 617/20 datë 06.05.2021, midis AK dhe BOE óT.....ó sh.p.k. dhe óSh.....ó sh.p.k., ku neni 4 i kontratës së sipërmarrjes ndryshohet si mëposhtë: Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 21.07.2021 deri 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. - Amendament shtyrje afati kontrate me nr.3422/2 prot. datë 25.11.2021, ku konfirmon shtyrjen e afatit të punimeve, data e rifillimit të punës do të jetë 25.11.2021 dhe data e përfundimit të punës do të jetë 09.12.2021. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 1157/5 prot, datë 06.05.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Mbikëqyrësit ing. N. M, me vlerë të kontratës së shërbimit 116,300 lekë pa tvsh. - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.4860/2 prot., datë 13.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe OE óG... C.....ó, me vlerë të kontratës së shërbimit 12,400 lekë pa tvsh. - Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.8 datë 30.04.2021, miratuar nga KKTK. - Librezat e masave, situacion përfundimtar etj.
Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, shpenzim i pajustificuar dhe i përfituar pa të drejtë shuma 249,900 lekë pa tvsh.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Nga DSHQ të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 249,900 lekë pa tvsh nga BOE óT.....ó sh.p.k. dhe óSh.....ó sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 617/20 prot. datë 06.05.2021, me objekt óSuvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve, vlerë kjo që përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve ing. N. M, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 1157/5 prot, datë 06.05.2021 dhe znj A.K me detyrë Drejtuese Projekti.

8. Zbatimi i kontratës “Riparimi, pastrimi dhe luçidimi i dyshemesë së hollit kryesor dhe katit të dytë të Pallatit të Kongreseve”.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 619/13 prot., datë 30.03.2021 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Kontraktorit BOE óP...S...ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Znj. B. A., me NIPT K.....N dhe óF...ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. Sh...F..., me NIPT J.....S, liçencë në zbatim NZ..... dhe R.SH.32. Vlera e kontratës është 5,935,522 lekë pa tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 30.03.2021 deri në 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Investitori i punimeve me anë të letrës 619/22 datë 11.05.2021 me lëndë njoftim mbi shtyrjen e afatit të punimeve, drejtuar Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit përcjell relacionin e shtyrjes së afatit të punimeve me nr.prot.619/21 datë 11.05.2021 ku thuhet se për arsye të aktiviteteve të mbajtura në datat 19-22 Prill 2021, ka pasur përgatitje për mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve, për këtë arsye kërkohet zgjatje afati.

Aneks Kontrata nr.1 me nr.619/23 prot. datë 12.05.2021, e kontratës së sipërmarrjes nr. Prot. 619/23 datë 30.03.2021, midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe BOE óP...S...ô sh.p.k. dhe óF...ô sh.p.k., ku neni 4 i kontratës së sipërmarrjes ndryshohet si mëposhtë: 4.1 Afati i zbatimit të kësaj kontrate shtyhet deri në datën 31.05.2021.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr. 1138/2 prot., datë 06.04.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Mbikëqyrësit OE óT...ô sh.p.k., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1724/4, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 80,000 lekë pa tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr. 1879/2 prot., datë 31.05.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe kolaudatorit ing. N. M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 9,000 lekë pa tvsh.

Projekti

Projekti është hartuar nga T... sh.p.k.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbal i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, është bërë në datën 06.04.2021. Nuk administrohen në dosjen e audituar njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit për fillimin e punimeve. Punimet kanë përfunduar me datë 31.05.2021, sipas afatit të amenduar të aneks kontratës nr.1 me nr.619/23 prot. datë 12.05.2021.

Korrespondenca e shtyrjes së afatit: Sipërmarrësi i punimeve me anë të letrës me nr. 94 prot. datë 11.05.2021, me lëndë: Kërkesë për shtyrje afati drejtuar Mbikëqyrësit të punimeve për dijeni Investitorit DSHQ, ku njofton se për arsye të ngjarjeve të paparashikuara të ndodhura gjatë periudhës së zbatimit të kontratës kanë ulur ritmin e punimeve dhe kërkohet shtyrje deri me datë 31.05.2021. Mbikëqyrësi i punimeve referuar letrës dërguar nga Sipërmarrësi i punimeve i drejtohet DSHQ me anë të letrës pa nr. Prot. datë 11.05.2021, parashtron arsyet e shtyrjes së afatit të punimeve dhe aprovon nga ana e mbikëqyrësit shtyrjen e afatit deri më datë 31.05.2021.

Investitori i punimeve me anë të letrës 619/22 datë 11.05.2021 me lëndë njoftim mbi shtyrjen e afatit të punimeve, drejtuar Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit përcjell relacionin e Drejtuesit të projektit. Relacioni i shtyrjes së afatit të punimeve me nr.prot.619/21 datë 11.05.2021 ku thuhet se për arsye të aktiviteteve të mbajtura në datat 19-22 Prill 2021, ka pasur përgatitje për mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve, për këtë arsye kërkohet zgjatje afati.

Librezat e masave janë miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve dhe situacioni përfundimtar është miratuar nga AK përfaqësuar nga Drejtoresha znj. Dh.F dhe Drejtuesi i Projektit znj. K. V, Sipërmarrësi i punimeve BOE óF...ô sh.p.k. & óP...S...ô sh.p.k. përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Zj. B. A. dhe drejtuesi teknik ing. M. N. dhe Mbikëqyrësi i punimeve óT...ô sh.p.k. me përfaqësues ligjor ing. D. Q.

Vlera e punimeve të certifikuara është 5,495,854 lekë pa tvsh ose 6,595,024.80 lekë me tvsh. Protokolluar në DSHQ me nr. Prot. 1869/2 datë 31.05.2021.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Projekt preventivi,
- 2) Libri i masave,
- 3) Situacioni përfundimtar,
- 4) Korrespondenca,
- 5) Ditarët e objektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Riparimi, pastrimi dhe luçidimi i dyshemesë së hollit kryesor dhe katit të dytë të Pallatit të Kongreseve”				
14.Lidhja e kontratës nr. 619/13 prot., datë 30.03.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 5,935,522 lekë pa tvsh / 7,122,626 lekë me tvsh BOE fitues “P...S...” sh.p.k. dhe “F...” sh.p.k.		16.Likuiduar deri datë 31.05.2021 me vlerë 6,595,024 lekë me t.v.sh.	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 6,595,024 lekë me t.v.sh.	18.Afati i kontratës në ditë (45 ditë) Fillimi punimeve: 06.04.2021 Përfundimi punimeve: 31.05.2021		19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr. 619/23 prot. datë 12.05.2021, për arsye pezullimi afati kohor i zbatimit në ditë pune nuk ndryshon, data e përfundimit të punimeve shtyhet me 31.05.2021.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve óT...ô sh.p.k	Licenca Nr: ...	Kontrata me nr. 1138/2 prot., datë 06.04.2021		
21. Kolaudatori i punimeve N. M	Licenca Nr:	Kontrata me nr. 1879/2 prot., datë 31.05.2021		
22.Akt Kolaudimi datë 31/05/2021	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 03/06/2021			

Nga auditimi i librezave të masave elektronike, situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
4	<i>Pastrim i sipërfaqes nga papastërtitë dhe mbetjet mbi mermer</i>	m2	149	3,926	3,926.89	3,773	153	22,797
5	<i>Zmerilim i sipërfaqes së mermerit me gurë cod 60,120,220,400,800</i>	m2	940	3,926	3,926.89	3,773	153	143,820

6	Rrashnim me pluhur ilustrues për sipërfaqe mermeri	m2	130	3,926	3,926.89	3,773	153	19,890
7	Lucidim me qeleshe dhe krem shkëlqyes	m2	130	3,926	3,926.89	3,773	153	19,890
Total								<u>206,397</u>

Në lidhje konstatimet kanë observuar shkresën me nr. 380/8 prot, datë 25.07.2022.

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoiobservimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Qëndrimi i observimeve të subjektit, ku shprehen:

Sipas mbikëqyrësit të punimeve:

Me anë të shkresës nr 380/8 prot., datë 25.07.2022, mbikëqyrësi i punimeve ka sjellë vizatimet e azhornuara finale të projektit dhe librezat e masave.

-Përgjigje e grupit të auditimit të KLSH-së.

Lidhur me observacionet e mbikëqyrësit të punimeve u kontrollua dokumentacioni i dërguar me anë të observacionit dhe u konstatua që:

Pas kontrollit të vizatimeve për katin e dytë të Pallatit të Kongreseve sipërfaqja e dhënë në vizatim dhe sipërfaqja respektive në tabelat e librezave të masave janë korresponduese me njëra tjetrën.

Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.

9. Zbatimi i kontratës “Restaurimi dhe pastrimi i mermerëve të fasadës së Pallatit të Kongreseve”.

Në lidhje me Akt Verifikimin nr. 6 datë 09.06.2022, nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: óRestaurimi dhe pastrimi i mermerëve të fasadës së Pallatit të Kongreseve, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Mbikëqyrësit të punimeve u konstatua që punimet e kryera janë realizuar konform Projektit dhe preventivit të rishikuar.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 4450/16 prot., datë 13.12.2021 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Kontraktorit OE óR....C...ô sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. R. P, me NIPT L.....A. Vlera e kontratës është 5,371,600 lekë pa tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 13.12.2021 deri në 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Për shtyrjen e punimeve korrespondenca midis palëve:

-Sipërmarrësi i punimeve me anë të letrës me datë 28.12.2021, me lëndë: Kërkesë për shtyrje afati të punimeve në objekt, drejtuar Mbikëqyrësit të punimeve, njofton se për arsye të kushteve atmosferike të ndodhura gjatë periudhës së zbatimit të kontratës ka qenë e pamundur të punohet pasi punimet kanë qenë në ambjent të hapur dhe kërkohet shtyrje deri me datë 07.01.2022.

-Mbikëqyrësi i punimeve referuar letrës dërguar nga Sipërmarrësi i punimeve i drejtohet DSHQ me anë të letrës datë 28.12.2021, parashtrohet arsyet e shtyrjes së afatit të punimeve, të cilat janë të njëjta me të Sipërmarrësit, kërkon investitorit shtyrjen e afatit deri më datë 07.01.2022.

-Investitori i punimeve me anë të letrës 1516/5 datë 28.12.2021 me lëndë konfirmim për shtyrje të afatit të punimeve, drejtuar Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit, për dijeni Drejtor Dh. F, ku Drejtuesi i projektit z. L. T konfirmon shtyrjen e punimeve dhe zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendim me shkrim të kontratës së nënshkruar.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr. 4987/2 prot., datë 13.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.F dhe Mbikëqyrësit óG... C....ô sh.p.k. përfaqësuar nga inxh. G.S, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ..., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 78,000 lekë pa tvsh. Afati i zbatimit të kësaj kontrate do të jetë duke filluar nga dita e fillimit të punimeve deri në

përfundimin e punimeve për procedurën me objekt Restaurimit dhe pastrimi i mermereve të fasadës së Pallatit të Kongreseve.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5419/2 prot., datë 28.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të përfaqësuar nga Drejtore znj. Dh.Fdhe OE ÓL....ô sh.p.k. përfaqësuar nga Z. I.D, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 7,000 lekë pa tvsh. Afati i zbatimit të kësaj kontrate fillon nga data 28.12.2021.

Projekti

Projekti është hartuar nga S.... Studio sh.p.k me nr. licence N.....

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit, proces verbali i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 13.12.2021. Sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit të punimeve dhe proces verbalit të përfundimit të punimeve, punimet kanë përfunduar me datë 07.01.2022, sipas afatit të amenduar të kontratës.

Për rishikimit e projektit është mbajtur dokumentacioni përkatës dhe janë bërë miratimet e tij nga të gjitha palët. Dokumentacioni i mbajtur janë si më poshtë:

- Proces Verbal konstatimi të punimeve që shtohen e hiqen në preventivin fillestar i mbajtur me datë 16/12/2021.
- Sipërmarrësi i punimeve me anë të letrës me datë 17.12.2021 drejtuar Mbikëqyrësit të punimeve G... C.... sh.p.k., për dijeni Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, me lëndë kërkesë për ndryshim volumesh në objekt, ku si rrjedhojë e azhurnimit u vu re se sasi të preventivit nuk përputheshin me matjet faktike
- Mbikëqyrësi i punimeve me anë të letrës me datë 17.12.2021 drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, për dijeni Mbikëqyrësit të punimeve G... C.... sh.p.k., me lëndë kërkesë për miratimin e ndryshimit të volumeve në preventivin fillestar, ku për përshtatje sa më të mirë të projektit me faktin dhe duke qenë se i shërbejnë anës funksionale të objektit janë punime që duhet të kryhen.
- Proces Verbal mbi miratimin përfundimtar të ndryshimeve në volume si edhe miratim të punimeve që shtohen dhe të punimeve që zbriten në preventivin fillestar të punimeve, i mbajtur me datë 20/12/2021.
- Tabela përmbledhëse e rakordimit të volumeve e miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Drejtuesi i Projektit z. L. T., Sipërmarrësi i punimeve OE ÓR....C...ô sh.p.k. përfaqësuar nga ing. R.P dhe Mbikëqyrësi i punimeve ÓG... C....ô sh.p.k. me përfaqësues ligjor ing. G. S. Zbriten 19,208 lekë pa tvsh dhe shtohen 14,228.42 lekë pa tvsh, vlera e kontratës zbritet me 4,979.58 lekë pa tvsh.
- Preventivi i ripunuar i miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Drejtuesi i Projektit z. L. T., Sipërmarrësi i punimeve OE ÓR....C...ô sh.p.k. përfaqësuar nga ing. R. Pdhe Mbikëqyrësi i punimeve ÓG... C....ô sh.p.k. me përfaqësues ligjor ing. G.S. Vlera e preventivit të ripunuar është 5,366,620.42 lekë pa tvsh.

Librezat e masave janë miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve dhe situacioni përfundimtar është miratuar nga Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Drejtoresha znj. Dh.Fdhe Drejtuesi i Projektit z. L. T., Sipërmarrësi i punimeve OE ÓR....C...ô sh.p.k. përfaqësuar nga ing. R. Pdhe Mbikëqyrësi i punimeve ÓG... C....ô sh.p.k. me përfaqësues ligjor ing. G. S. Vlera e punimeve të çertifikuara është 5,366,620.42 lekë pa tvsh ose 6,439,944.50 lekë me tvsh.

Akt kolaudimi për objektin: Restaurimi dhe pastrimi i mermerëve të fasadës së Pallatit të Kongreseve datë 21/01/2022. U mbajt nga mbikëqyrësi i punimeve ÓG... C....ô sh.p.k. me përfaqësues ligjor ing. G. S., OE ÓR....C...ô sh.p.k. përfaqësuar nga ing. R. P, kolaudatori i punimeve ÓL...ô sh.p.k. përfaqësuar nga ing. I. D.

Proces Verbal i marrjes në dorëzim të punimeve për objektin: Restaurimi dhe pastrimi i mermerëve

të fasadës së Pallatit të Kongreseve, me nr.5419/4 prot. datë 25/01/2022. Komisioni i ngritur me Urdhër nr. 34 prot. datë 07.01.2022, i përbërë nga zj. S. M, z. A.D dhe z. E. K, me anë të këtij proces verbal të marrjes në dorëzim, pranon dhe merr në dorëzim objektin Restaurimi dhe pastrimi i mermerëve të fasadës së Pallatit të Kongreseve.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Restaurimi dhe pastrimi i mermerëve të fasadës së Pallatit të Kongreseve”				
14.Lidhja e kontratës nr. 4450/16 prot., datë 13.12.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 5,371,600 lekë pa tvsh / 6,445,920 lekë me tvsh OE fitues “R....C...” sh.p.k.		16.Likuiduar deri datë 07.01.2022 me vlerë 6,439,944 lekë me t.v.sh.	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 6,439,944 lekë me t.v.sh.	18.Afati i kontratës në ditë (15 ditë) Fillimi punimeve: 13.12.2021 Përfundimi punimeve: 07.01.2022		19. Zgjatja e kontratës Amendim kontrate datë 28.12.2021, konfirmohet shtyrja e punimeve deri 07.01.2022.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve óG... C....ô sh.p.k	Licenca Nr: MK	Kontrata me nr. 4987/2 prot., datë 13.12.2021		
21. Kolaudatori i punimeve óImes-Dô	Licenca Nr: MK	Kontrata me nr. 5419/2 prot., datë 28.12.2021		
22.Akt Kolaudimi datë 21/01/2022	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 25/01/2022			

2.6. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR

Mbi auditimin e ushtruar në “Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, në bazë të programit të auditimit nr. 380/1, datë 12.04.2022)

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të tij hartohet nga institucioni, duke ndjekur ecurinë për miratimin përfundimtar për tu vënë në dispozicion fondet buxhetore. Monitorimi i veprimtarisë së këtij institucioni është si më poshtë vijon;

Për periudhën objekt auditimi 2019,2020,2021 deri 31 Mars 2022 rezultoi se:

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në varësi të Këshillit të Ministrave e cila vepron në bazë të Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar në fuqi, në veçanti në bazë të ligjit me Nr.7582 datë 13.07.1992ô Për ndërmarrjet shtetëroreô i ndryshuar si dhe me VKM Nr.34 datë 07.01.1999, ôPër Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimi i Personaliteteve të Larta Shtetëroreô

Sa më sipër, në përmbushje, sipas kërkesave të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ôPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinô, i ndryshuar, ôNëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktualô.

Kështu,Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar pyetësin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitet 2019, 2020,2021 me shkresat nr.584/2, datë 26.02.2020, dhe nr.989/2, datë 23.03.2021 dhe shkresën nr.544/3, datë 28.02.2022 drejtuar Ministrisë së Financave

dhe Ekonomisë.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

-Aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Me urdhrin nr.54 datë 09.03.2020, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i përbërë nga Titullari i Institucionit dhe anëtarët.

Me urdhrin nr.235 datë 16.03.2021, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i përbërë nga Titullari i Institucionit dhe anëtarët.

Me urdhrin nr.20 datë 07.13.2022, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i përbërë nga Titullari i Institucionit dhe anëtarët.

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 óPër rregullat e etikës në administratën publikeó, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjelltë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, Institucioni ka hartuar një kod etike me vendimin nr.6, datë 27.02.2017.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është person juridik në vartësi të Këshillit të Ministrave e cila vepron në bazë të Kushtetutës, Legjislacionit shqiptar në fuqi, në vecanti në bazë të ligjit Nr.7582 datë 13.07.1992 óPër Ndërmarrjet Shtetëroreó i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.34 datë 07.01.1999. óPër Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta Shtetëroreó i ndryshuar. Në Rregulloren e brendshme janë të përcaktuara qartë struktura organizative e DSHQ, funksionet dhe detyrat e funksioneve të larta të Drejtimit, funksionet e drejtorive dhe sektorëve, si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Në Përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, neni 15 óRregulla të përgjithshme për delegimin e detyraveó, si dhe Kapitulli III óDelegimi i detyraveó, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi konstatuar se ka rregullore të brendshme të miratuar nga Këshilli Drejtues, ku janë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre.

d. Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 01.01.2019 - 31.03.2022 nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve pasi punonjësit e administratës DSHQ janë pranuar me Kodin e Punës.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimit, nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për periudhën Janar në Dhjetor 2019 dhe Janar në Dhjetor 2020 referuar

Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 óMjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ó, paragrafët óPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreó dhe óProfesionalizmi i stafitó. Institucioni ka kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse.

Për vitin 2019, më së shumti janë ndjekur programet e trajnimeve për punonjësit e sektorëve të financës, prokurimeve dhe të burimeve njerëzore. Nga sektori i Burimeve Njerëzore është kryer nëpërmjet postës elektronike përcjellja e kalendarëve të Programeve të Trajnimeve dhe Moduleve përkatëse për vitin 2019 si dhe periudhën Prill - Dhjetor 2019 të ASPA-s (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike).

Viti 2020

Për vitin 2020, për pjesën më të madhe të punonjësve nuk janë ndjekur dhe kryer programe trajnimi për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe karantina në pjesën më të madhe të tij. Si pasojë e pandemisë shërbimet e ASPA-s (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) kanë qenë të pezulluara dhe nuk ka pasur përcjellje të Kalendarëve të Programeve të Trajnimeve dhe Moduleve.

-Janë zhvilluar dhe ndjekur trajnime online vetëm për specialist të sektorit të auditit të brendshëm në zbatim të Urdhrit të Ministrisë së Financave Nr. 260 datë 27.10.2020.

Viti 2021

Për vitin 2021, janë zhvilluar dhe ndjekur trajnime online për specialist të sektorit të auditit të brendshëm në zbatim të Programit të trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm miratuar me Urdhër nr 345, datë 31.12.2020 të Ministrisë së Financave.

2. Menaxhimi i riskut.

Nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve për vitin 2019, 2020 dhe 2021. Nga institucioni u citua se regjistrat e riskut janë hartuar në bazë të kërkesave të IPA, u konstatua se në regjistrat e riskut janë futur të gjitha pasqyrat e plotësuar me objektivat vjetore të aktivitetit të Drejtorisë së Eventeve Qeveritare Publike dhe jo Publike, Drejtorisë Administrative, Drejtorisë së Menaxhimit të Udhëtimeve Shtetërore, Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorinë e Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit të Rezidencave.

Me urdhrin nr.187, datë 22.08.2019, është emëruar kordinatori regjistratit të riskut znj.D.Xh.

Me urdhrin nr.152, datë 03.09.2020, është emëruar kordinatori regjistratit të riskut znj.L.Gj.

Me urdhrin nr.842, datë 17.06.2021, është emëruar kordinatori regjistratit të riskut znj.D.Xh

Nga auditimi u konstatua se, është realizuar për punonjësit trajnimi mbi menaxhimin e riskut, në vitin 2019 muaji Nëntor, por nuk është realizuar për punonjësit trajnimi mbi menaxhimin e riskut për vitin 2020 dhe vitin 2021, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe referuar kapitullit III të “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Nga auditimi është konstatuar se, janë hartuar gjurmët e auditimit sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó neni 16 óDetyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimitó pika 2 ku përcaktohet: “*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*”, si dhe Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 anekset 2, 3 dhe 4.

Gjurmët e auditimit për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë të protokolluar me Nr.prot.912/2 të datës 27.06.2021 dhe në të janë të përcaktuara qartë Procesi, Referenca Ligjore, Aktivitetet e kontrollit dhe Struktura me personin përgjegjës, të miratuara në fund nga Titullari Institucionit,

Drejtori Ekonomik, Drejtori Administrativ, Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, Drejtori i Eventeve Qeveritare Publike dhe Jopublike, Shefi Sektorit të Trajtimit Ushqimor, Shefi i Sektorit të Menaxhimit të Rezidencave dhe Drejtori i Shërbimit dhe Udhëtimeve Shtetërore.

4. Informim komunikimi.

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës ka raportuar tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, duke hartuar raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Punonjësit brenda institucionit vijnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

Institucioni nuk ka faqen e tij zyrtare të website.

5. Monitorimi.

- Nga auditimi konstatohet se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1 të nenit 4 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin: òNëpunës autorizues i nivelit të dytë”, dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitet e vartëse, me buxhet më vete të njësive së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...ò* u konstatuan se për të tre vitet objekt auditimi janë përpiluar planet vjetore të auditit të brendshëm.

Me vendimin nr.32, datë 28.09.2018. është bërë miratimi i planit të auditit të brendshëm për vitin 2019-2021 e firmosur nga Këshilli drejtues.

Me vendimin nr.47, datë 01.10.2019. është bërë miratimi i planit të auditit të brendshëm për vitin 2020 e firmosur nga Këshilli drejtues.

Me vendimin nr.32, datë 28.09.2021. është bërë miratimi i planit të auditit të brendshëm për vitin 2022-2024 e firmosur nga Këshilli drejtues.

Monitorimet dhe raportimet 12 mujore për ekzekutimin e buxhetit nuk janë përpiluar. Këto raportime konsistojnë në rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit, si dhe në raportimet që Drejtoria e Financës bën për raportin vjetor të DSHQ-së mbi performancën e produkteve të buxhetit për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, duke mos lidhur realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Mungesa e raporteve të monitorimit 12 mujore si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitet e Qeverisjes Qendroreò.*

Titulli i Gjetjes	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin
Situata:	1-Nga auditimi u konstatua se, punonjësit janë trajnuar mbi menaxhimin e riskut vetëm në muajin Nëntor 2019 por nuk janë trajnuar në vitet pasardhëse. 2- Institucioni nuk ka krijuar një website.
Kriteri:	1-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.</i>

Ndikimi/efekti:	-Mungesa e trajnimeve çdo vit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negative për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. -Mungesa e transparencës për publikun lidhur me njohjen dhe veprimtarinë e këtij institucioni.
Shkaku:	Mosveprimi i titullarit të institucioni mbi hartimin e një program trajnimi mbi menaxhimin e riskur si dhe krijimin krijimin e website te institucionit me qëllim rritjen e transparencës.
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/E mesme /E lartë
Rekomandimi	- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit si dhe referuar kapitullit III të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. -Titullari i Institucionit duhet të marri masa për krijimin e faqes zyrtare WEBSITE të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

2.7. VLERËSIMI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve, si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Auditimi i përputhshmërisë me Ligjin nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

- Struktura e Auditimit të Brendshëm në Agjencinë për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare është e organizuar në rang sektori dhe përmban në organikën e saj 3 auditues (1 përgjegjës sektori dhe tre specialistë), të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 133, datë 31.08.2018, óPër miratimin e organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritareó dhe Urdhrit të Kryeministritme nr.149 datë 05.11.2019, óPër miratimin e organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritareó.

Gjatë vitit 2019, struktura ka funksionuar kryesisht me 2 auditues (2 specialistë).

Gjatë vitit 2020, struktura ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë).

Gjatë vitit 2021, struktura ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë).

Nga auditimi i dosjeve të personelit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, rezultoi se nga 2 prej nëpunësve të këtij sektori vetëm njëri prej tyre disponon “Certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”, , ndërsa specialisti tjetër nuk e disponon pasi është në proces certifikimi.

Nga auditimi konstatohet se mungesa e përgjegjësit të sektorit të auditimit cenon procesin e auditimit, pasi reflektohet në performancën e këtij sektori pasi ka çuar në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga strukturat përgjegjëse të auditimit.

Objektivat kryesore:Qëllimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm të DSHQ-së, është që nëpërmjet veprimtarisë së tij të pavarur të japë siguri objektive dhe të ofroj këshilla për drejtimin, me qëllim shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarisë së DSHQ-së në përmbushjen e objektivave të veta si dhe të ndihmojë për vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit të riskut me qëllim rritjen e

efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë Institucion dhe të njësive vartëse të tij.

Raportimi me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave

- Nga auditimi u evidentua se në muajin tetor të vitit paraardhës janë hartuar planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm që do realizohen për vitin pasardhës, duke marrë miratimin nga Drejtori i Shërbimeve Qeveritare, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, si dhe duke i përcjellë në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kjo në përputhje me: Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publikó, neni 12, germa d, është dërguar në DHAB óProgrami vjetor i auditimit 2019 dhe plani strategjik 2019 - 2021ó me shkresën nr. 3887, datë 28.09.2018; óProgrami vjetor i auditimit 2020 dhe plani strategjik 2020-2022ó me shkresën nr. 4465 prot, datë 01.10.2019; óProgrami vjetor i auditimit 2021 dhe plani strategjik 2021-2023ó me shkresën nr. 3813/1 prot, datë 28.09.2021

Nga DSHQ është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm óRaportimi vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të DSHQó me shkresën nr. 143/1, datë 14.02.2020, óPër raportimin e veprimtarisë audituese për vitin 2019 dhe evidencat përkatëseó, për vitin 2020 me shkresën nr.522, datë 12.02.2021, dhe për vitin 2021 me shkresën nr.100/2, datë 15.02.2022, në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 ópër auditimin e brendshëm në sektorin publikó, neni 14, germa óçó.

Raportimet janë dërguar brenda afateve kërkuara dhe janë sipas kërkesave dhe metodologjisë së kërkuar nga DHAB.

Me miratimin e ligjit 114/2015 të óAuditimit të Brendshëm për Sektorin Publikó, Sektori i auditimit ka hartuar kartën e auditimit, miratuar me Vendimin nr. 41, datë 28.12.2015 të Këshillit Drejtues i përbërë nga : K.V, V. B, M. Dh dhe T. F.

Viti 2019

Në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të miratuar për vitin 2019, *me shkresën nr. 3887, datë 28.09.2018;*, ishin parashikuar të kryhen 8 auditime dhe janë realizuar 7 auditime. Gjatë kësaj periudhe, struktura ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë). Janë realizuar auditimet e mëposhtme:

1. Auditimi i Drejtorisë së Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca, Sektori i Shërbimit/Trajtimit Ushqimor.
2. Auditimi i Drejtorisë së Eventeve Qeveritare, Publike dhe Jopublike.
3. Auditimi i Drejtorisë Administrative, Sektori i Burimeve Njerëzore, Specialist Protokoli, Specialist Arkivi të DSHQ.
4. Auditimi i Drejtorisë Ekonomike, Sektori i Financës dhe Kontabilitetit.
5. Auditimi i Drejtorisë së Shërbimeve, Sektori i Mirëmbajtjes së Godinave të DSHQ-së.
6. Auditimi i Sektorit të Prokurimeve të DSHQ-së.
7. Auditimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Udhëtimeve Shtetërore, Qendra e Shërbimeve të Transportit/Parku i Delegacioneve.

Veprimtaria e punës audituese është bërë mbi bazën e analizës së riskut duke mbuluar me misionet auditimi të gjithë veprimtarinë e DSHQ. Për përmirësimin e sistemeve janë dhënë rekomandime të cilat konsistojnë në korrigjimin e gabimeve/pasaktësive, krijimin e gjurmëve të auditimit për çdo proces apo transaksion në zbatim të akteve ligjore, raporti vjetor i Sektorit të AB të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, përfshin aktivitetin dhe performancën e këtij sektori për periudhën janar - dhjetor 2019. Gjatë kësaj periudhe raportuese ky sektor e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në zbatim të planit vjetor 2019 të auditimit të brendshëm të miratuar me Vendimin nr.32, datë 28.09.2018 nga Këshilli Drejtues i DSHQ-së.

Plani vjetor i Sektorit të Auditit të Brendshëm 2019, është hartuar duke pasur parasysh auditime me bazë sistemi, auditime gjithëpërfshirëse, ashtu dhe ato me bazë risku.

Plani vjetor 2019 është rishikuar dhe miratuar me Vendim nr. 42, datë 26/06/2019, óMiratimin e

ndryshimit të planit të 6-mujorit të dytë të auditimit të brendshëm për vitin 2019^o, dhe përcjellë me shkresë nr. 2597/2 prot, datë 28/06/2019, në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Konkretisht, Sektori i Auditit të Brendshëm të DSHQ-së, për periudhën raportuese janar - dhjetor 2019 nga 8 (tetë) auditime të planifikuara, gjithsej ka kryer 7 (shtatë) misione auditimi, të cilat janë kryer nga audituesit e brendshëm, Znj.Sh. I, Z. A. H dhe Znj. S. N.

Për çdo mision auditimi është hartuar dhe miratuar programi i auditimit duke përcaktuar afatin e auditimit, audituesit e brendshëm, objektin e auditimit, llojin e auditimit, metodat e auditimit.

Për periudhën raportuese gjithsej janë lënë 27 (njëzet e shtatë) rekomandime, të pranuar nga njësitë e audituara, nga të cilat 12 (dymbëdhjetë) prej tyre janë zbatuar, 13 (trembëdhjetë) janë në proces zbatimi. Theksojmë se 10 rekomandime janë lënë dhe pranuar nga subjektet në muajin dhjetor 2019.

Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.

Për periudhën janar - dhjetor 2019, sektori i auditit të brendshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare ka ushtruar funksionin e tij në lidhje me realizimin e programit vjetor të auditimit, miratuar me Vendimin nr. 32, datë 28.09.2018, nga Këshilli Drejtues i DSHQ-së, dhe përcjellë me shkresën nr.3641/1 prot, datë 09.10.2018 pranë Drejtorisë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm.

Viti 2020

Plani vjetor i Sektorit të Auditit të Brendshëm 2020, është hartuar duke pasur parasysh auditime me bazë sistemi, auditime gjithëpërfshirëse, ashtu dhe ato me bazë risku. Gjatë kësaj periudhe, struktura ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë).

Plani vjetor 2020 është rishikuar dhe miratuar me Vendim nr. 21, datë 29.06.2020, ^oMiratimin e ndryshimit të planit të 6-mujorit të dytë të auditimit të brendshëm për vitin 2020^o, dhe përcjellë me shkresë nr.1987 prot, datë 07.07.2020 në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Konkretisht, Sektori i Auditit të Brendshëm të DSHQ-së, për periudhën raportuese janar - dhjetor 2020 nga 8 (tetë) auditime të planifikuara, gjithsej ka kryer 6 (gjashtë) misione auditimi, të cilat janë kryer nga audituesit e brendshëm, Z. A.H dhe Znj. S. N.

Për çdo mision auditimi është hartuar dhe miratuar programi i auditimit duke përcaktuar afatin e auditimit, audituesit e brendshëm, objektin e auditimit, llojin e auditimit, metodat e auditimit. Në çdo auditim sipas rastit janë mbajtur aktet e verifikimit.

Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.

Për periudhën janar - dhjetor 2020, sektori i auditit të brendshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare ka ushtruar funksionin e tij në lidhje me realizimin e programit vjetor të auditimit, miratuar me Vendimin Nr. nr.47, datë 01.10.2019 dhe ndryshuar me Vendimin nr.21, datë 29.06.2020 nga Këshilli Drejtues i DSHQ-së, dhe përcjellë me shkresën nr 1987 prot, datë 07/07/2020, ^oRishikim i Planit Vjetor për 6-mujorin e dytë të vitit 2020 të DSHQ-së^o pranë Drejtorisë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm.

Konkretisht auditimet e kryera janë si më poshtë:

1-Auditimi ^oPër auditimin e Zbatimit e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë për sistemin e pagave të punonjësve të DSHQ-së^o. Ky auditim është realizuar sipas programit të auditimit të miratuar nga Titullari me shkresë nr.144/2 prot, datë 03.02.2020, me objekt: Zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë për sistemin e pagave të punonjësve të DSHQ-së^o, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019.

2-Auditimi i Drejtorisë së Eventeve Qeveritare, Publike dhe Jopublike Pallati i Kongreseve ^oZbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë për sistemin e Pallatit të Kongreseve^o, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2019.

3-Auditimi i Drejtorisë Ekonomike, Sektori i Financës dhe Kontabilitetit. Ky auditim është realizuar sipas programit të auditimit miratuar nga Titullari me shkresë nr. 1995/1 prot., datë 09.07.2020, do të vlerësohet ^oVlerësimi i Sistemit të Detyrimeve të prapambetura në DSHQ^o,

për periudhën Janar 2019 në Qershor 2020.

4-Auditimi i Sektorit të Prokurimeve të DSHQ-së. Ky auditim është realizuar sipas programit të auditimit të miratuar nga Titullari i Institucionit me shkresë nr.2918/2 prot, datë 04.09.2020 me objekt: Auditimin e Përputhshmërisë dhe financiar të Sektorit të Prokurimeve të DSHQ-së, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2020

5- Auditimi i Drejtorisë Ekonomike. Ky auditim është realizuar sipas programit të auditimit të miratuar nga Titullari i Institucionit me shkresë 4363/2 prot, datë 09.12.2020, sektori i auditit të brendshëm zhvilloi misionin e auditimit në Drejtorinë Ekonomike, mbi auditimin Financiar&Përputhshmërisë, me objekt: vlerësimi i Sistemit të Inventarëve në DSHQ, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021.

6- Grupi i Menaxhimit Strategjik

Për periudhën raportuese gjithsej janë lënë 24 (njëzet e katër) rekomandime, të pranuar nga njësitë e audituara.

Viti 2021

Raporti vjetor i Sektorit të Auditit të Brendshëm të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, përfshin aktivitetin dhe performancën e këtij sektori për periudhën janar - dhjetor 2021. Gjatë kësaj periudhe, struktura ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë). Ky sektor e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në zbatim të planit vjetor 2021 të auditimit të brendshëm të miratuar me Vendimin nr.25, datë 30.09.2021 dhe ndryshuar me Vendimin nr.26, datë 21.07.2021 nga Këshilli Drejtues i DSHQ-së.

Plani vjetor i Sektorit të Auditit të Brendshëm 2021, është hartuar duke pasur parasysh auditime me bazë sistemi, auditime gjithëpërfshirëse, ashtu dhe ato me bazë risku.

Plani vjetor 2021 është rishikuar dhe miratuar me Vendim nr.25, datë 30.09.2020, miratimin e ndryshimit të planit të 6-mujorit të dytë të auditimit të Brendshëm për vitin 2021, me Vendim nr 26, datë 21.07.2021 dhe përcjellë me shkresë nr.3932/1 prot, datë 08.10.2021 në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Konkretisht, Sektori i Auditit të Brendshëm të DSHQ-së, për periudhën raportuese janar - dhjetor 2021 nga 8 (tete) auditime të planifikuara, gjithsej ka kryer 4 (katër) misione auditimi.

Për periudhën raportuese janë lënë 3 (tre) rekomandime të pranuar nga njësitë e audituara të cilat janë zbatuar. Në vijim të ndryshimeve të bazës ligjore të auditit të brendshëm në sektorin publik konkretisht në mbështetje të ligjit nr.114, datë 22.10.2015, me vendimin nr.83, datë 03.02.2016 të Këshillit të Ministrave janë miratuar edhe kriteret e krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, pikërisht e cilëson neni 3 i tij. Në zbatim të bazës ligjore të sipërpërmendur për të siguruar një implementim të të gjitha fazave të auditimit të brendshëm gjatë një angazhimi auditimi referuar manualit të auditit të brendshëm theksojmë se organizimi i strukturës të auditit të brendshëm miratuar me Urdhër nr. 149, datë 5.11.2019, të Kryeministrit, sektori i auditimit është në përputhje me nenin 3 (tre) të VKM-së nr.83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pra 1 (një) drejtues dhe 2 (dy) specialistë.

Me urdhër të titullarit të institucionit nr. 1813, datë 24.11.2021, nr.4863 Prot, datë 24.11.2021, miratuar me Vendim nr.47, datë 26.11.2021 të Këshillit Drejtues ka ndryshuar plani i auditimit për vitin 2021.

Sipas këtij programi janë parashikuar të kryhen 8 auditime dhe janë realizuar 4 auditime.

Për vitin 2021 konkretisht auditimet e kryera janë si më poshtë:

1- Drejtoria e Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca, Sektori i Shërbimit/Trajtimit Ushqimor të D.SH.Q-së për periudhën 01/01/2019 deri më 31/12/2020.

2-Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse vlerësohet për zbatimin e ligjshmërisë, përputhshmërisë për Sektorin e Mirëmbajtjes së Ambienteve të Jashtme/Gjelbërimi dhe Sektorin e Pastrimit për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2020.

3--Auditimi i sektorit të prokurimeve. Ky auditim është realizuar sipas programit të auditimit miratuar nga Titullari me shkresë nr. 4131/2 prot, datë 14.10.2021, auditimin e përputhshmërisë dhe

financiar do të vlerësohet óVlerësimi i sistemit të prokurimeve publike në DSHQ, për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2021

4-Auditimi i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Udhëtimeve Shtetërore, për monitorimin e shpenzimeve të kryera lidhur me konsumin e karburantit nga parku i delegacioneve dhe nga Sektori i shërbimeve të përgjithshme në Kryeministri.

Titulli i Gjetjes	Mbi Auditimin e Brendshëm
Situata	Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se struktura e auditit të brendshëm ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë) duke çuar në uljen e numrit të auditimeve gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë për raportet e auditimit.
Kriteri:	Ligjin nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
Ndikimi/efekti:	Mungesa e përgjegjës të sektorit të auditimit cenon procesin e auditimit, pasi reflektohet në performancën e këtij sektori pasi ka çuar në uljen e numrit të auditimeve. Dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë.
Shkaku:	Vakanca e krijuar në strukturat e auditimit të brendshëm
Rëndësia e shkeljes:	E ulët/E mesme/E lartë
Rekomandimi	Titullari i Institucionit të marrë masa, për plotësimin e vendit vakant pasi mungesa e përgjegjës të sektorit të auditimit cënon procesin e auditimit dhe reflektohet në performancën e këtij sektori e cila ka çuar në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga strukturat përgjegjëse.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i PBA-ve të përgatitura nga institucioni konstatohet se:

- Për vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 12-mujore të buxhetit. DSHQ financohet nga buxheti i shtetit për llogarinë 603-Subvencione dhe llogarinë 231-Investime. Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit me financim të brendshëm konsistojnë në rakordimet që DSHQ bën me Kryeministrinë për arritjen e objektivave për të cilat alokohen këto fonde. Mungesa e raporteve të monitorimit 12-mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreó.

- Grupi i auditimit konstatoi se institucioni ndër vite nuk ka një program zhvillimi afatmesëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar. Në programin ekonomik të secilit vit, institucioni ka bërë parashikimin dhe ka vendosur objektivat vetëm për vitin pasardhës, dhe jo për një periudhë afatmesme, duke mos përcaktuar objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, në faqet 14-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: DSHQ të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore.

- DSHQ të hartojë një pasqyrë të plotë të objektivave që synon të arrijë institucioni dhe bazën e objektivave, të përgatitet një program zhvillimi afatmesëm për qëndrueshmërinë ekonomike-financiare të institucionit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Dosjet personale të nëpunësve kanë mangësi dhe parregullsi në dokumentacion si: fleta e inventarit është e pafirmosur nga i punësuar dhe nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore; mungesa e raportit mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kontrollin mjekësor bazë, si dhe dëshmitë e panoterizuara, veprime në kundërshtim me VKM nr. 117 datë 5.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, lidhja 1, ku evidentohen dokumentet që duhet të jenë pjesë e dosjes së personelit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa nga për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas bazës ligjore në fuqi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit u konstatua se sa i takon zyrave të DSHQ-së dhe Pallatit të Kongreseve, nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve, edhe pse nga komisioni i inventarizimit në raportin përfundimtar, janë evidentuar aktive të cilat konsiderohen si jashtë përdorimit për shkak të ndryshimit të teknologjisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publikó, i ndryshuar, pika 96 .

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 29-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të DSHQ-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komisioni i Inventarizimit, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të prokurimit rezultoi sa më poshtë vijon:

4.1. Nga auditimi u konstatua se në DSHQ dosjet e prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit..

4.2. Nga auditimi i procedurave të prokurimit konstatohet procesverbali nr.2 i hapjes dhe vlerësimit të procedurës nuk është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 12 të ligjit Nr. 9643, óPËR PROKURIMIN PUBLIKÓ pasi në asnjë prej procesverbaleve, as në raportin përmbledhës nuk janë përcaktuar vlerat e ofertave të ardhura nga operatorët, por janë vendosur vetëm dokumentacioni i sjellë prej tyre.

Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 39-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

4.2. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të merren masa për të gjitha rastet e procedurave të prokurimit në vijim, hartimi i procesverbalit nr.2 të hapjes dhe vlerësimit të ofertave

të kryhet në përputhje me bazën ligjore në mënyrë respektimin e transparencës në këto procedura.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

5.1. Nga auditimi u konstatua se, punonjësit janë trajnuar mbi menaxhimin e riskut vetëm në muajin Nëntor 2019 por nuk janë trajnuar në vitet pasardhëse në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

5.2. Institucioni nuk ka krijuar faqen e tij zyrtare website.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 76-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit si dhe referuar kapitullit III të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

5.2 Rekomandimi: Titullari i Institucionit duhet të marrë masa për krijimin e faqes zyrtare WEBSITE të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare me qëllim rritje e transparencës së institucionit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e auditit të brendshëm ka funksionuar me 2 auditues (2 specialistë) duke çuar në uljen e numrit të auditimeve gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë për raportet e auditimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 7, në faqet 80-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa, për plotësimin e vendit vakant pasi mungesa e përgjegjësit të sektorit të auditimit cenon procesin e auditimit dhe reflektohet në performancën e këtij sektori e cila ka çuar në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga strukturat përgjegjëse.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i kontratës *óHidroizolimi i tarracës së Pallatit të Kongreseve* me nr.1871/9 prot., datë 24.08.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik *óB...ô sh.p.k.* dhe *óE.. K..ô sh.p.k.*, me vlerë 24,653,040 lekë pa tvsh, u konstatua se gjatë zbatimit nuk justifikohet zëri:

Transport dheu me auto deri 10.0 km, sasia 379.65 m3, me vlerë totale 170,846 lekë pa tvsh.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 39-75 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE *óB...ô sh.p.k.* dhe *óE.. K..ô sh.p.k.* në vlerën 170,846 lekë pa tvsh.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i kontratës *óSuvatim me suva plastike i fasadës në Pallatin e Kongreseve* me nr.617/20 prot., datë 06.05.2021 midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik *óT.....ô sh.p.k.* dhe *óSh.....ô sh.p.k.*, me vlerë 9,264,800 lekë pa tvsh, u konstatua se gjatë zbatimit ka punime të situacionuara por të pajustificuar,

me vlerë totale 249,900 lekë pa tvsh.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 39-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE ÓT.....ô sh.p.k. dhe ÓSh.....ô sh.p.k. në vlerën 249,900 lekë pa tvsh.

Menjëherë

V. ANEKSE

Anekset japin informacion mbi:

Aneksi 1. “Sqarim rreth llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSHô;

Aneksi 2. óQasja dhe metodologjia e auditimitô;

Aneksi 3. óAnaliza e risqeveô.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSI I - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Llojet e opinionëve të aplikuar nga KLSH.

a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë dhe përdoruesit e fundit.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do të tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si òtheksimi i çështjes ò përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).

b. OPINIONET E MODIFIKUARA:

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditin. (ISSAI 1700.4;6;17)
- Evidentohet që njësia ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
 - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
 - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)
- Evidentohen raste që lidhe me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e përshkruara më poshtë:

Opinion i modifikuar. Opinion i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe konçize të

çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion i negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion i qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI II

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Gjatë procesit të planifikimit, janë mbledhur informacion për subjektin në mënyrë që të vlerësohet risku dhe të përcaktohen nivelet e materialitetit për hartimin e procedurave të auditimit. Evidencat e mbledhura më pas janë vlerësuar si një bazë për formimin e përfundimeve dhe për qëllime raportimi. Materialiteti është i rëndësishëm për këtë vlerësim.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe
- teste të detajeve

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pështetja specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si óefektivó;
- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%,; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si ópjesërisht efektivó ose ójo efektivó.

Përzgjedhjen e urdhër pagesave sipas ***drejtimit nr. 3*** të programit të auditimit është bërë duke parë brenda kontekstit të natyrës specifike të shpenzimeve, të cilat mbartin risk, duke marrë në konsideratë dhe faktorët si:

- vlerat e pagesës
- ngjarje apo transaksione të rëndësishme si kontrata të rëndësishme prokurimi, kontrata për investime afatgjatë, të cilat mund të jenë shkas për ndonjë risk më të lartë.
- afati kohor që nga data urdhër pagesës me datën e faturës së lëshuar për kryerjen e shërbimit, për të analizuar arsyen e këtyre vonesave në ekzekutim, duke kaluar afatin 30 ditore të parashikuar në legjislacion.
- ekzekutimi i pagesave në lidhje me vendimet e formës së prerë dhe kthimin e tij në titull ekzekutiv, duke marrë parasysh afatin e zgjatjes së pagesës nga vendimi deri në ekzekutimin e pagesës nga institucioni.

Mbulimi me auditim i shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime

Klasa 6 (llog 602)	Shpenzime operative faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2019	418,194,275	153,743,043	37%
Viti 2020	429,131,879	160,716,501	37%

Viti 2021	354,716,486	163,562,089	46%
Janar - Mars 2022	111,745,137	54,841,701	49%

Për vitin 2019, grupi i auditimit ka audituar urdhër shpenzime në vlerën 153,743,043 lekë ose 37% të totalit. Për vitin 2020 janë audituar në vlerë 160,716,501 lekë ose 37% e totalit të shpenzimeve, për vitin 2021 janë audituar në vlerë 163,562,089 lekë ose rreth 46% e totalit, ndërsa për vitin 2022 janë audituar 54,841,701 lekë ose rreth 49% e totalit.

Mbulimi me auditim i prokurimeve:

-Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019 në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë realizuar 124 procedura prokurimi, me vlerë totale 140,725,712 lekë pa TVSH

Ndër të cilat:

- Ç Procedure e Hapur - Vlera e Kontratave pa TVSH në lekë - 0 procedura;
- Ç Kerkese për propozim - Vlera e Kontratave pa TVSH në 58,741,401 lekë - 23 procedura;
- Ç Marrëveshje Kuadër (ABP) - Vlera e Kontratave pa TVSH në lekë në 0 procedura;
- Ç Negocim pa shpallje paraprake - Vlera e Kontratave pa TVSH- lekë - 0 procedura;
- Ç Prokurim me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH në 9,825,656 lekë - 23 procedura;
- Ç Blerje nën 100.000 lekë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 264,380 lekë - 7 procedura;
- Ç Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 596,375 lekë - 7 procedura;
- Ç Ceremonial - Vlera e Kontratave pa TVSH në 72,124,762 lekë në 64 procedura;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 10 procedura kërkesë për propozim me fond limit 41,420,435 lekë pa tvsh.

-Janë audituar 12 procedura ceremonial me fond limit 45,338,840 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 62% e vlerës së procedurave të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

-Nga auditimi u konstatua për vitin 2020 në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë realizuar 76 procedura prokurimi, me vlerë totale 88,188,859 lekë pa TVSH

Ndër të cilat:

- Ç Procedure e Hapur - Vlera e Kontratave pa TVSH në 18,922,514 lekë - 1 procedurë;
- Ç Kerkese për propozim - Vlera e Kontratave pa TVSH në 26,421,848 lekë - 7 procedura;
- Ç Marrëveshje Kuadër - Vlera e Kontratave pa TVSH në 6,980,801lekë - 2 procedura;
- Ç Negocim pa shpallje paraprake - Vlera e Kontratave pa TVSH në lekë - 0 procedura;
- Ç Prokurim me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH në 4,909,070 lekë - 15 procedura;
- Ç Blerje nën 100.000 lekë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 536,616 lekë - 12 procedura;
- Ç Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 573,202 lekë - 8 procedura;
- Ç Ceremonial - Vlera e Kontratave pa TVSH - 29,844,808 lekë - 31 procedura;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 8 procedura prokurimi me fond limit në total 53,169,035 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 61% e vlerës së procedurave të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

-Nga auditimi u konstatua se për vitin 2021 në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë realizuar 126 procedura prokurimi, me vlerë totale 158,114,081 lekë pa TVSH

Ndër të cilat:

- Ç Procedure e Hapur - Vlera e Kontratave pa TVSH në 36,662,350 lekë - 2 procedura;
- Ç Procedure e Hapur e thjeshtuar - Vlera e Kontratave pa TVSH- 3,441,092 lekë - 1 procedurë;
- Ç Kerkese për propozim - Vlera e Kontratave pa TVSH në 43,386,997 lekë - 12 procedura;
- Ç Marrëveshje Kuadër - Vlera e Kontratave pa TVSH në 20,060,344 lekë - 2 procedura;
- Ç Negocim pa shpallje paraprake - Vlera e Kontratave pa TVSH në lekë - 0 procedura;
- Ç Prokurim me vlerë të vogël - Vlera e Kontratave pa TVSH në 4,327,051 lekë - 17 procedura;
- Ç Blerje nën 100.000 lekë - Vlera e Kontratave pa TVSH në 2,348,701lekë - 43 procedura;

Ç Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH ñ 939,884 leke - 13 procedura;

Ç Ceremonial ñ Vlera e Kontratave pa TVSH ñ 49,296,359 leke - 36 procedura;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 14 procedura me vlerë 108,975,692 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 68% e vlerës së procedurave të realizuara në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

ANEKSI III:

ANALIZA E RISQEVË:

1. Risku i brendshëm (i trashëgueshëm) IR për DSHQ:

Risku i brendshëm i shmangies nga përputhshmëria, ose gabimi, është analizuar nga grupi i auditimit duke përdorur gjykimin në vlerësimin e një sërë faktorësh, (në referencë të kreut 4.2 të MAP të KLSH, fq. 33- 35), që përfshijnë:

Shkallëzimi IR:

Risku i ulët: ngjyrë jeshile, deri në 0,5

Risku i moderuar: ngjyrë verdhë, 0.6 deri në 0,9

Risku i lartë: ngjyrë kuqe, 1

- kompleksitetin e strukturave menaxhuese: verdhe, vlerësuar **0,6**
- kompleksitetin e kuadrit normues dhe ligjor: jeshile, vlerësuar **0.4**
- hyrjen në zbatim të dispozitave të reja ligjore ose ndryshimet në rregullat ekzistuese: verdhë, vlerësuar **0,7**
- shërbime dhe programe të realizuara nga palë të treta: jeshile deri tek e verdhë në pak raste, vlerësuar **0,8**
- pagesa dhe fatura të kryera mbi baza pretendimesh ose deklarimesh: (nuk janë vërtetuar raste të tilla nga testimi), jeshile, vlerësuar **0,3**
- numrin dhe shumë llojshmërinë e përfituesve: verdhë, vlerësuar **0,8** meqenëse nomenklatura e çështjeve që trajtohen dhe operatorëve që operojnë është shumë e shtrirë dhe mund të kërcënohet nga risqet e keqmenaxhimit material.

Mesatarja për 6 zërat e listuar më sipër: $3,6/6 = 0,6$ d.m.th ngjyrës te verdhë, risk i mesëm.

2. Risku i kontrollit (CR) për institucionin DSHQ-së:

Risku i kontrollit është risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Kur audituesi parashikon të mbështetet në vlerësimin e riskut të kontrollit për të zvogëluar shkallën e përdorimit të procedurave thelbësore (substantive) sa i takon përputhshmërisë, ai kryen gjithashtu vlerësime paraprake të riskut të kontrollit dhe planifikon e kryen teste të kontrollit, në mënyrë që të mbështesë këtë vlerësim. (Shiko fq. 34 të manualit)

Statusi i kontrollit te brendshëm	Risku i kontrollit	Përshkrimi	Risku i kontrollit për DSHQ-në
Shumë i mirë	I ulët Deri në 0.15	kontrollat kanë funksionuar vazhdimisht në mënyrë efektive, gjatë gjithë periudhës në shqyrtim.	
I mirë	I ulët 0.15 - 0.25	janë vërejtur mangësi në efektivitetin dhe vazhdimësinë e kontrollit, por sistemi në tërësi nuk konsiderohet ôjo i besueshëmô.	I mesëm (vlerësuar 0.21)
dobët	I lartë 0.26 - 1.0	kontrollat janë të pabesueshme, p.sh. kontrollat nuk kanë funksionuar sipas pritshmërive dhe/ose në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës nën shqyrtim dhe/ose nuk është i mundur testimi i tyre.	

3. Risku i moszbulimit (DR) për institucionin DSHQ-së:

Risku i moszbulimit është risku që grupi i auditimit të mos zbulojë gabime materiale të cilat kanë ndodhur dhe nuk janë parandaluar ose zbuluar dhe korrigjuar në kohë nga sistemi i kontrollit të brendshëm.

ôKontrolli i Lartë i Shtetit kërkon një nivel sigurie 95% nga testet e kryera, që mund të vijnë nga kontrollat ose tërësisht nga procedurat thelbësore, në varësi të vlerësimit të audituesit sa i takon riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollitô (faqe 35). Për institucionin e KLSH risku i auditimit

është pranuar 5 %. Pra **AR= 5%**.

Risku i auditimit AR:

$AR = IR \times CR \times DR$

$5\% = 0.63 \times 0.23 \times DR$

$0.05 = 0.63 \times 0.23 \times DR$

$DR = 0.05 / 0.126 = 0.39 < 5\%$.

PERZGJEDHJA E KAMPIONIT TË AUDITIMIT:

Tre mënyrat e përzgjedhjes së kampioneve: Statistikore dhe Jostatistikore:

- Përzgjedhja e 100% të artikujve,
- Përzgjedhja e artikujve të veçantë;
- Testimi i kampionëve
- *Pasqyrat financiare të bilancit: audituar **100 %** llogaritë e bilancit për vitin 2019-2020, për të cilin jepet opinion; transaksionet financiare janë audituar me zgjedhje dhe sondazhe llogaritë e tjera (aktivit dhe pasivit);*
- *Audituar **100 %** llogaritë e të drejtave të arkëtueshme dhe detyrimeve të pagueshme;*
- *Prokurimet publike e audituara **62 % për vitin 2019 dhe 61% për vitin 2020 dhe 68% për vitin 2021, e fondeve të prokuruar mbuluar me auditim .***
- *Nga kontrolli i sistemit të dokumentacionit justifikuese, për urdhër pagesat, u testuan me zgjedhje muajt Qershor, Korrik, Nëntor të vitit 2019; Gusht, Tetor, Nëntor të vitit 2020; Prill, Maj, Korrik të vitit 2021 dhe muaji Shkurt 2022;*
- *Procedurat e MFK audituar **100 %** për gjithë periudhën objekt auditimi;*

■ Raporte dhe Informacione

Janë administruar dhe shfrytëzuar:

- PBA 2020-2022, 2021-2023, dhe 2022-2024.
- Pyetësorët e vetëvlerësimit për vitin 2019, 2020 dhe 2021
- Raportet e auditimit të brendshëm.

